



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË NP "TERMOKOS" SH.A PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, prill 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të NP "Termokos" sh.a për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të NP "Termokos" sh.a (Termokos), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të NP "Termokos" sh.a deri me 31 dhjetor 2025, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2025, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Për shkak të përfshirjes së rivlerësimit të regjistri i granteve, të hyrat e shtyra janë mbivlerësuar për 1,741,280€. Në 13 raste pasuritë e financuara nga grantet me kosto fillestare prej 4,056,598€ (vlerë neto 3,255,425€), janë regjistruar gabimisht si pasuri të zhvlerësueshme. Po ashtu, në 10 raste, kostoja e aseteve është nënvlerësuar për 1,465,128€;
- C1 Si rezultat i trajtimit jo të duhur kontabël, pasuritë afatgjata janë nënvlerësuar për 3,980,792€, dhe njëkohësisht janë mbivlerësuar për 3,375,447€, për shkak të klasifikimit të gabuar të parapagimeve si pasuri dhe aplikimit të zhvlerësimit mbi to;
- B2 Në 47 raste, shpenzimet e interesit, pagave dhe konsulencës, në vlerë totale prej 4,469,410€, janë regjistruar si pasuri të zhvlerësueshme, pa iu atribuar pasurisë përkatëse;
- C2 Njohje e gabuar e të hyrave nga amortizimi i granteve ka rezultuar në pasqyrim jo të drejtë në pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ekuitetit, për shumën 133,681€;
- A1 Në dy raste, pasuritë të klasifikuara si investime në vijim, në vlerë prej 457,508€ janë përfshirë njëkohësisht edhe në regjistrin e pasurive në përdorim, duke rezultuar në mbivlerësim të pasurive për këtë shumë;
- A2 Pasuritë në vlerë neto prej 8,166,058€, të cilat i përkasin të njëjtës klasë, nuk janë përfshirë në procesin e rivlerësimit;

- B3 Në katër (4) raste, llogaritë e pagueshme janë mbivlerësuar në pasqyrat financiare për 401,713€, ndërsa në një (1) rast janë nënvlerësuar për 40,000€;
- B4 Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në pasqyra financiare, krahasuar me shënimet analitike, kanë rezultuar me një diferencë për 316,108€. Po ashtu, pesë (5) raste, llogarive të arkëtueshme në vlerë 128,777€, nuk janë të mbështetura me dëshmi përkatëse;
- B5 Në kuadër të zërit “Konsumatorët tjerë”, ndërmarrja ka prezantuar një llogari të arkëtueshme me emërtimin “Borxhi i ngrirë” në vlerë prej 371,802€, e cila rrjedh nga një vendim i Bordit dhe aksionarëve i vitit 2010;
- A3 Mospërputhje në politikat kontabël dhe shpalosje jo e plotë e informacionit në pasqyrat financiare sa i përket matjes së asetëve dhe metodologjisë së llogaritjes së lejimeve;
- A4 Ndërmarrja nuk ka njohur provizione për 26 kontestet gjyqësore me humbje të mundshme prej 600,936€ dhe fitime të mundshme prej 16,297€ në përputhje me kërkesat përkatëse. Po ashtu, prona e ndërmarrjes me sipërfaqe 24,309 m² e cila nuk është në shfrytëzim të ndërmarrjes, nuk është shpalosur në pasqyrat financiare.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të NP "Termokos" sh.a kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A5 Konsumatorëve pa pajisje matëse u është faturuar konsumi i përbashkët në bazë të Draft-Procedurës për Leximin e Matësve të Energjisë Termike, e pa miratuar nga ZRRE. Vlera totale e faturuar për këtë kategori (C33) arrin 333,222€;
- A6 Në dy raste të procedurave të prokurimit janë evidentuar mangësi në vlerësimin e ofertave zbatimin e plotë të kërkesave të dosjes së tenderit;
- B6 Ndërmarrja nuk ka trajtuar ankesat e konsumatorëve brenda afateve kohore të përcaktuara me procedurat e brendshme;
- A7 Ndërmarrja ka realizuar pagesa në vlerë 50,400€ për gjashtë (6) kontrata për “Shfrytëzimin e hapësirave reklamuese në media online/portale”, të cilat nuk ishin zhvilluar përmes procedurave të parapara me Ligjin për Prokurimin Publik;
- B7 Ndërmarrja nuk ka kryer plotësisht harmonizimin e regjistrit të pasurive dhe mjeteve me raportet e komisioneve të inventarizimit;
- B8 Sipas regjistrit të konsumatorëve të vitit 2025, ndërmarrja ka 25,597 konsumatorë aktiv, ndërsa kontrata të lidhura janë vetëm 15,638 prej tyre;
- A8 Në një rast rekrutimi nuk na janë siguruar të gjitha dokumentet e procedurës, si rezultat i së cilës nuk ishte e mundur të vlerësohej nëse janë zbatuar kërkesat e rregullores për testimin me shkrim;
- A9 Ndërmarrja ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen Publike Banesore (NPB) duke u mbështetur në marrëveshjen me Komunën e Prishtinës pa bazë të qartë autorizuese për lidhjen e kontratave të tilla, duke devijuar nga kërkesat ligjore dhe roli i përcaktuar në marrëveshjen bazë. Po ashtu, trajtimi i avanseve nuk është në përputhje me natyrën e marrëdhënieve kontraktuale të krijuara.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit mbi to

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet në raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Ne kemi marrë parasysh nëse informacionet në raportin për menaxhmentin janë në përputhje me informacionet në pasqyrat financiare dhe deklarata e qeverisjes korporative përfshinë shpalosjet e kërkuara me nenet 7 dhe 10 të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP "Termokos" sh.a.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i NP "Termokos" sh.a është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të NP "Termokos" sh.a në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të NP "Termokos", sh.a me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të NP "Termokos" sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e NP "Termokos" sh.a, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Mangësitë kryesore të identifikuar të cilat e kanë ndikuar opinionin financiar janë: pasaktësi materiale në njohjen dhe klasifikimin e pasurive dhe të hyrave, përfshirë mbivlerësime dhe nënvlerësime të konsiderueshme, kapitalizim të gabuar të shpenzimeve[BK1.1] dhe trajtim jo të duhur të granteve; pasqyrim jo i drejtë i të hyrave dhe i disa zërave në pasqyrat financiare; si dhe mangësi në evidencë, shpalosje dhe njohje të provizioneve, të cilat në tërësi kanë ndikuar në paraqitjen e drejtë të pozicionit financiar.

Mangësitë kryesore të identifikuar të cilat e kanë ndikuar opinionin e pajtueshmërisë janë: faturim pa bazë të miratuar nga ZRRE, mangësi në prokurim dhe realizim pagesash jashtë procedurave ligjore, mosrespektim i afateve dhe procedurave për konsumatorët, si dhe dobësi në menaxhimin e kontratave, pasurive dhe proceseve të rekrutimit, të cilat në tërësi tregojnë nivel të ulët të pajtueshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullative.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 20 rekomandime, prej tyre nëntë (9) janë rekomandime të reja, nëntë (9) të përsëritura dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos prezantim i saktë i të hyrave të shtyra nga grantet

Gjetja

Sipas kërkesave të SNK 20 -Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndhimën Qeveritare, paragrafët 12 dhe 17 përcaktojnë se grantet qeveritare të lidhura me pasuritë duhet të njihen si të hyra në mënyrë sistematike gjatë periudhave në të cilat njësia ekonomike njih si shpenzim kostot përkatëse që grantet synojnë të kompensojnë, respektivisht gjatë jetës së dobishme të pasurisë së lidhur. Po ashtu, paragrafi 24 kërkon që grantet që lidhen me pasuritë të njihen si të hyra të shtyera dhe të amortizohen në mënyrë sistematike gjatë jetës së dobishme të pasurisë.

Ndërkohë, sipas SNK 16 - Pasuritë, Impiantet dhe Pajisjet, paragrafët 31, 34 dhe 39 përcaktojnë se rivlerësimi ndikon vetëm në vlerën kontabël të pasurisë dhe ndryshimet nga rivlerësimi njihen në kapital (rezervë rivlerësimi) dhe jo në fitim ose në të hyra operative. Si rrjedhojë, rivlerësimi nuk krijon bazë për rritje të të hyrave nga grantet dhe nuk duhet të ndikojë në njohjen apo matjen e tyre.

Kemi evidentuar se efekti i rivlerësimit të pasurive ishte reflektuar gabimisht në regjistrin e granteve, duke ndikuar në rritjen e vlerës së të hyrave të shtyera. Si rezultat, të hyrat e shtyera janë mbivlerësuar për 1,741,280€.

Tutje,

- Në 13 raste, pasuritë e financuara nga grantet me kosto fillestare prej 4,056,598€ ose vlerë neto prej 3,255,425€, ishin regjistruar gabimisht si pasuri të zhvlerësueshme. Këto përfshijnë shpenzimet për konsulencë dhe parapagime, të cilat duhet të kapitalizohen dhe t'i atribuohen pasurive përkatëse në kuadër të projekteve apo kontratave specifike, dhe jo të trajtohen si pasuri të pavarura; si dhe
- Në 10 raste, kostoja fillestare e pasurive të financuara nga grantet ishte nënvlerësuar në shumën prej 2,083,044€, ku si pasojë, vlera neto në libra (VNL) e këtyre pasurive ishte nënvlerësuar për 1,465,128€.

Trajtimi i gabuar i rivlerësimit të pasurive si një bazë për rritjen e të hyrave nga grantet ka ndodhur për shkak të dobësive në kontrollin e brendshëm dhe në njohjen e udhëzimeve për regjistrimin dhe njohjen e granteve sipas standardeve kontabël. Po ashtu, kjo situatë është edhe si pasojë e mos mbajtjes së evidencave të duhura në vitet e mëparshme dhe e mos koordinimit midis departamentit të financave dhe njësisë përgjegjëse për menaxhimin e projekteve.

Ndikimi

Ky trajtim ka shkaktuar mbivlerësim material në pasqyrat financiare, duke përfshirë mbivlerësim të të hyrave të shtyra dhe të ardhurave nga grantet, rritje të pasaktë të fitimit të periudhës dhe kapitalit, si dhe ndikim në pasqyrën e rrjedhës së parasë përkatësisht aktivitetet operative. Kjo ul besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe rrit rrezikun që përdoruesit e tyre të marrin vendime të pasakta.

Rekomandimi B1

Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që regjistri i granteve të rishikohet dhe të korrigojen të gjitha pasaktësitë e shkaktuara nga reflektimi i rivlerësimit të pasurive. Njohja e të hyrave nga grantet duhet të bëhet në mënyrë sistematike gjatë jetës së dobishme të pasurisë së lidhur, në përputhje me kërkesat e standardeve përkatëse. Po ashtu, duhet të sigurohet mbajtja e evidencave dhe dokumentacionit të plotë mbështetës për pasuritë e financuara nga grantet. Kjo duhet të arrihet përmes forcimit të kontrolleve të brendshme dhe koordinimit efektiv ndërmjet njësive përgjegjëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Dobësi në regjistrimin e pasurive**Gjetja**

Korniza Konceptuale për Raportimin Financiar paragrafi 4.6 përcakton se gjatë vlerësimit nëse një zë e plotëson përkufizimin e një aktivi, detyrimi apo kapitali neto, duhet ti kushtohet vëmendje përmbajtjes themelore të tij dhe realitetit ekonomik dhe jo vetëm formës së tij ligjore. Tutje, sipas paragrafit 4.12, megjithëse kapaciteti i një njësie ekonomike për të kontrolluar përfitimet zakonisht është rezultat i të drejtave ligjore, pavarësisht një zë mund të plotësojë përkufizimin e një aktivi edhe kur nuk ka kontroll ligjor. Ndërsa sipas paragrafit 4.41, kriteri i dytë për njohjen e një zëri është fakti nëse ky zë ka një kosto ose vlerë e cila mund të matet me besueshmëri. Tutje SNK 16, Pasuritë afatgjata materiale, pika 50, shumat e amortizueshme e një aktivi do të shpërndahe mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme.

Ne kemi vërejtur se trajtimi i pasurive nuk ishte bërë në përputhje me kërkesat e standardeve përkatëse. Dobësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Në 22 raste, kostoja fillestare e pasurive është nënvlerësuar me shumën 3,980,792€, për shkak të regjistrimit të tyre sipas vlerës së pagesës (vlera e situacionit minus avansi), dhe jo sipas vlerës së plotë të punëve dhe shërbimeve të kryera, duke mos reflektuar përmbajtjen reale ekonomike të transaksioneve;
- Në katër (4) raste, parapagimet për projektet përkatëse, në vlerë 3,375,447€, janë regjistruar gabimisht si pasuri dhe mbi to është aplikuar zhvlerësimi, ndonëse këto nuk plotësojnë kriteret për njohje si pasuri të amortizueshme.

Parregullsitë e identifikuar tek asetet janë rezultat i gabimeve gjatë regjistrimit të disa transaksioneve, veçanërisht avanseve, të cilat kanë ndikuar në regjistrimet pasuese. Po ashtu, mungesa e harmonizimit ndërmjet gjendjes faktike të aseteve dhe regjistrat kontabël ka kontribuar në pasaktësitë e evidentuara.

Ndikimi

Mungesa e regjistrimit të plotë të aseteve dhe regjistrimi i disa prej tyre me vlera jo të sakta ndikon në besueshmërinë e informacionit financiar dhe prezantim jo të drejtë të aseteve në pasqyrat financiare.

Rekomandimi C1

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që menaxhmenti të korrigjojë trajtimin kontabël të pasurive, duke i njohur ato me koston e plotë të punëve dhe shërbimeve të kryera, në përputhje me standardet përkatëse. Parapagimet duhet të klasifikohen dhe trajtohen në mënyrë të drejtë si aktive parapaguese dhe jo si pasuri të amortizueshme, deri në momentin e pranimit dhe vënies në përdorim të pasurisë. Po ashtu, duhet të sigurohet mbajtja e një regjistri të plotë dhe të saktë të pasurive, si dhe harmonizimi i rregullt ndërmjet evidencave kontabël dhe gjendjes faktike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Trajtim jo i duhur i kostove të projekteve**Gjetja**

Sipas SNK 16, paragrafi 16 kostoja e një pasurie përfshin çdo kosto të ngarkueshme drejtpërdrejtë për të sjellë aktivin në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga menaxhmenti. Ndërsa paragrafi 17 përcakton se kosto të atribueshme janë edhe kostot e përfitimeve të punonjësve (siç përcaktohet në SNK 19 Përfitimet e punonjësve) që vijnë drejtpërdrejt nga ndërtimi ose blerja e zërit të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

Ndërmarrja nuk kishte zbatuar kërkesat e standardeve me rastin e regjistrimit të pasurive. Kjo është vërejtur në 47 raste, ku shpenzimet e interesit, pagave dhe konsulencës, në vlerë totale prej 4,469,410€, janë regjistruar si pasuri të veçanta të zhvlerësueshme, pa ia bashkangjitur pasurive përkatëse për të cilat janë kryer. Megjithëse, në sistemin e brendshëm financiar të ndërmarrjes ekziston një modul i veçantë sipas projekteve, ku kostot evidentohen në mënyrë të ndarë për secilin projekt, këto të dhëna nuk janë reflektuar në regjistrin e pasurive dhe rrjedhimisht as në pasqyrat financiare.

Kjo ka ndodhur si pasojë e regjistrimit fillestar të kostove si investime në vijim, ndërsa me rastin e vënies në përdorim nuk është kryer shpërndarja e tyre tek pasuritë përfundimtare.

Ndikimi

Regjistrimet e tilla ndikojnë që vlera e pasurive dhe zhvlerësimi për to, të mos pasqyrojë saktë vlerën reale të tyre në fund të vitit, duke ndikuar në paraqitjen jo të drejtë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi B2

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të merren veprimet e nevojshme korrigjuese duke bërë rishpërndarjen e kostove të kapitalizuara sipas pasurive konkrete. Po ashtu, duhet të rishikohet zhvlerësimi dhe vlera neto e tyre si dhe të sigurohet që të gjitha kostot e evidentuara në nivel projekti të reflektohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në regjistrin e pasurive dhe në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Pasqyrim jo i drejtë i të hyrave nga amortizimi i granteve**Gjetja**

Sipas SNK 1- një njësi ekonomike duhet të përgatit pakon e plotë të pasqyrave financiare e cila ka për qëllim të përgjithshëm të sigurojë informacione lidhur me pozicionin financiar, performacën financiare, fluksin monetar, si dhe shënimet shpjeguese të dobishme për përdoruesit e pasqyrave financiare vjetore. Sipas SNK 20 (paragrafët 12, 17 dhe 24), grantet që lidhen me pasuritë duhet të njohën si të hyra të shtyera dhe të amortizohen sistematikisht gjatë jetës së dobishme të pasurisë, duke reflektuar si të hyra në pasqyrën e të ardhurave dhe si detyrim në bilanc, duke ndikuar indirekt në pasqyrën e rrjedhës së parasë. Sipas SNK 16 (paragrafët 31, 34 dhe 39), rivlerësimi i pasurive duhet të ndikojë vetëm në kapitalin e rezervës së rivlerësimit dhe nuk duhet të ndikojë në të hyrat operative, duke pasqyruar vetëm si ekuitet në pasqyrën e ekuitetit. Po ashtu, sipas SNK 7 - qëllimi i pasqyrës së rrjedhës së parasë është informacioni rreth fluksit monetar të një njësie ekonomike është i dobishëm për të pajisur përdoruesit e pasqyrave financiare me një informacion bazë për të vlerësuar aftësinë e njësisë ekonomike për të gjeneruar mjete monetare ose ekuivalentë të tyre dhe për të vlerësuar nevojat e njësisë ekonomike për të përdorur këto flukse monetare.

Efekti i rivlerësimit të pasurive është trajtuar gabimisht në regjistrin e granteve, duke u reflektuar si bazë për njohjen e të hyrave operative nga amortizimi në pasqyrën e të ardhurave. Si rezultat, në të hyrat operative janë përfshirë në mënyrë të gabuar 133,681€, të cilat burojnë nga efekti i rivlerësimit dhe jo nga aktivitetet operative, në kundërshtim me kërkesat e SNK 16 dhe SNK 20.

Kjo gjendje ka ardhë si pasojë e mungesës së ndarjes së qartë ndërmjet trajtimit të rivlerësimit të pasurive dhe njohjes së të hyrave nga grantet, si dhe dobësitve në harmonizimin e regjistrave të pasurive, granteve dhe amortizimit.

Ndikimi

Trajtimi jo i saktë i të hyrave nga amortizimi i granteve ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të të ardhurave, rrjedhës së parasë dhe ekuitetit, duke ulur besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe rritur rrezikun për vendimmarrje jo të bazuar në informacione të sakta nga përdoruesit.

Rekomandimi C2

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që trajtimi i granteve të bëhet i ndarë dhe në përputhje me standardet, pa u ndërlidhur me efektet e rivlerësimit të pasurive, si dhe të ndërmerren veprime për korrigjimin e të hyrave të njohura gabimisht nga amortizimi në pasqyrën e të ardhurave. Njëkohësisht, duhet të sigurohet që pasqyra e rrjedhës së parasë dhe ekuitetit të pasqyrojnë vlerat reale, të reflektojnë saktë këto korrigjime. Është e nevojshme të forcohen kontrollet e brendshme për harmonizimin e regjistrave të pasurive, granteve dhe amortizimit, për të parandaluar përsëritjen e këtij gabimi në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mbivlerësimi i pasurive në përdorim për shkak të përfshirjes së pasurive të investimeve në vijim**Gjetja**

Sipas kërkesave të formatit për përgatitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) dhe parimeve të International Financial Reporting Standards (SNRF), pasuritë duhet të paraqiten dhe të klasifikohen në mënyrë të drejtë dhe të ndarë në: (i) pasuri në përdorim dhe (ii) investime në vijim. Gjithashtu, sipas SNK 16, pasuritë që janë në përdorim duhet të zhvlerësohen sistematikisht gjatë jetës së tyre të dobishme, ndërsa pasuritë në fazën e investimeve në vijim nuk i nënshtrohen zhvlerësimit deri në momentin e vendosjes në përdorim. Klasifikimi i saktë dhe aplikimi i zhvlerësimit janë të domosdoshme për paraqitje të drejtë dhe të paanshme të pasqyrave financiare.

Në dy raste, pasuritë në vlerë prej 457,508€ ishin regjistruar si investime në vijim, ndërkohë që njëkohësisht ishin përfshirë edhe në regjistrin e pasurive në përdorim. Ky trajtim ka e rezultuar në mbivlerësim të pasurive për të njëjtën shumë.

Kjo gjendje kishte ardh si pasojë e mungesës së kontrolleve të brendshme efektive për klasifikimin dhe rishikimin periodik të pasurive, përkatësisht në ndarjen ndërmjet investimeve në vijim dhe pasurive në përdorim.

Ndikimi

Kjo gjendje tregon dobësi në klasifikimin dhe trajtimin kontabël të pasurive, duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare.

Rekomandimi A1

Bordi i drejtorëve duhet të forcojë kontrollet e brendshme për rishikimin periodik të regjistrit të pasurive për të siguruar klasifikim të saktë të pasurive duke ndarë qartë investimet në vijim nga pasuritë në përdorim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A2 - Mos aplikimi i rivlerësimit për të gjithë klasën e pasurive****Gjetja**

Sipas kërkesave të SNK 16, kur zbatohet modeli i rivlerësimit, ai duhet të aplikohet për të gjithë klasën e pasurive dhe jo vetëm për pasuri individuale (paragrafi 36). Po ashtu, sipas paragrafit 39, rritjet nga rivlerësimi duhet të njihen në kapital përmes rezervës së rivlerësimit.

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja kishte aplikuar rivlerësimin e pasurive, mirëpo, pasuritë në vlerë neto prej 8,166,058€, të cilat i përkasin të njëjtës klasë, nuk ishin përfshirë në procesin e rivlerësimit. Si rrjedhojë, rivlerësimi nuk është zbatuar në mënyrë të plotë dhe konsistente për të gjithë klasën e pasurive, duke rezultuar në nënvlerësim ose mbivlerësim të mundshëm të ekuitetit.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i dobësive në kontrollet e brendshme, mungesës së një rishikimi gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurive, si dhe mos sigurimit të informatave të plota dhe në kohë për të gjitha pasuritë gjatë procesit të rivlerësimit.

Ndikimi Mosaplikimi i rivlerësimit për të gjithë klasën e pasurive rezulton në paraqitje jo të drejtë dhe jo konsistente të pasurive, duke ulur krahasueshmërinë ndërmjet tyre dhe duke ndikuar në shtrembërimin e amortizimit dhe vlerës neto. Për më tepër, kjo ndikon drejtpërdrejt në nënvlerësimin e rezervës së rivlerësimit në kapital, pasi rritjet potenciale të vlerës së pasurive që nuk janë rivlerësuar nuk janë reflektuar në këtë zë.

Rekomandimi A2 Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që rivlerësimi të zbatohet në mënyrë të plotë dhe konsistente për të gjithë klasën e pasurive, në përputhje me kërkesat e SNK 16. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime për rishikimin dhe përfshirjen e të gjitha pasurive në procesin e rivlerësimit, me qëllim që rezerva e rivlerësimit të paraqitet në mënyrë të drejtë dhe të plotë në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Diferenca në llogaritë e pagueshme

Gjetja Sipas SNK 1, paragrafi 15, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë drejtë pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar.

Në katër (4) raste, llogaritë e pagueshme rezultojnë të mbivlerësuar në pasqyrat financiare për 401,713€, ndërsa në një (1) rast janë nënvlerësuar për 40,000€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së harmonizimeve periodike me furnitorët dhe kontrolleve të pamjaftueshme të brendshme nga zyrtarët përgjegjës për menaxhimin dhe monitorimin e llogarive të pagueshme, si dhe mungesës së procedurave sistematike për konfirmimin e saldove në fund të periudhës raportuese.

Ndikimi Mangësitë e identifikuar ndikojnë në besueshmërinë e informacionit financiar dhe prezantim jo të saktë të detyrimeve në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B3 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që, regjistri i detyrimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore, në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mos barazimi i llogarive të arkëtueshme në mes shënimeve kontabël dhe të dhënave të prezantuara në pasqyrat financiare si dhe mungesë të dëshmime përkatëse.**Gjetja**

Sipas SNK 1: "Pasqyrat financiare duhet të paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera, në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, siç përcaktohen në Kornizën Konceptuale për Raportim Financiar." Sipas Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12: "Shoqëritë tregtare janë të obliguara të verifikojnë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit përmes inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime të tyre mbështetëse, i cili duhet të jetë në përputhje me librat kontabël."

Llogaritë e arkëtueshme të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar nuk janë në përputhje me evidencat analitike përkatëse. Në pasqyrat financiare, këto llogari janë raportuar në vlerë neto prej 5,404,876.56 €, ndërsa sipas regjistrave analitikë rezultojnë në shumën 5,088,769 €, duke krijuar një diferencë prej 316,108€.

Për më tepër, ndërmarrja nuk kishte kryer harmonizimin e plotë të llogarive të arkëtueshme me evidencat kontabël dhe me klientët përkatës, me ç'rast janë identifikuar pesë (5) raste të llogarive të arkëtueshme, në vlerë totale prej **128,777€**, të cilat nuk janë në përputhje me regjistrat kontabël dhe për të cilat mungojnë dëshmi mbështetëse adekuate.

Këto mospërputhje tregojnë se saldot e raportuara nuk mbështeten plotësisht nga evidencat analitike dhe dokumentacioni përkatës, duke reflektuar mungesë të një procesi të plotë dhe sistematik të verifikimit dhe harmonizimit të llogarive të arkëtueshme.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i mungesës së rishikimeve dhe verifikimeve të rregullta të llogarive të arkëtueshme nga menaxhmenti, si dhe kontrolleve të pamjaftueshme për harmonizimin e tyre me evidencat kontabël dhe raportimin financiar.

Ndikimi

Mosbarazimi i identifikuar dhe mungesa e dëshmime mbështetëse tregojnë dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe ndikojnë në besueshmërinë e raportimit financiar. Kjo rritë rrezikun që pasqyrat financiare të mos paraqesin në mënyrë të drejtë gjendjen reale të llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi B4

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që menaxhmenti të zbatojë procedura të rregullta të harmonizimit dhe rishikimit të llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, duhet të sigurohet dokumentacion i plotë mbështetës për çdo saldo të raportuar, me qëllim që të garantohet saktësia dhe besueshmëria e pasqyrave financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Prezantimi i llogarisë së arkëtueshme si “borxh i ngrirë”.**Gjetja**

Sipas SNK 1: “Pasqyrat financiare duhet të paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera, në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, siç përcaktohen në Kornizën Konceptuale për Raportim Financiar.”

Në kuadër të zërit “Konsumatorët tjerë”, ndërmarrja ka prezantuar një llogari të arkëtueshme me emërtimin “Borxhi i ngrirë” në vlerë prej 371,802€. Kjo shumë rrjedh nga një vendim i Bordit dhe aksionarëve i vitit 2010, përmes të cilit janë ngrirë borxhet deri në janar 2006, me kusht që konsumatorët të paguajnë 100% të detyrimeve nga viti 2006 e tutje.

Në vitin 2023, një komision i themeluar nga ndërmarrja kishte hartuar një raport përfundimtar mbi gjendjen e këtyre borxheve, duke konstatuar se, për shkak të mungesës së pretendimeve reale për arkëtimin e tyre, kjo shumë nuk duhet të vazhdojë të paraqitet si llogari e arkëtueshme në pasqyrat financiare. Megjithatë, pavarësisht këtij konstatimi, ndërmarrja nuk ka ndërmarrë veprime për trajtimin kontabël të kësaj çështjeje as gjatë vitit 2025, duke vazhduar ta prezantojë këtë saldo si pjesë të llogarive të arkëtueshme.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mosadresimit të kësaj çështjeje nga Bordi i Drejtorëve dhe mungesës së vendimmarrjes për trajtimin e duhur kontabël të “borxhit të ngrirë”.

Ndikimi

Mos trajtimi i kësaj çështjeje rezulton në mbivlerësim në mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme dhe paraqitje jo të saktë të tyre në pasqyrat financiare. E gjithë kjo, ndikon në besueshmërinë e raportimit financiar.

Rekomandimi B5

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të ndërmerren veprime konkrete për trajtimin e kësaj llogarie në përputhje me natyrën e saj ekonomike. Kjo do të mundësojë paraqitjen e saktë dhe të drejtë të llogarive të arkëtueshme në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Mospërputhje në politikat kontabël dhe shpalosje jo e plotë e informacionit në pasqyrat financiare****Gjetja**

Sipas kërkesave të SNK 16 - Pasuritë, Impiantet dhe Pajisjet (paragrafët 29 dhe 31), njësia ekonomike duhet të zgjedhë një politikë kontabël duke përdorur ose modelin e kostos ose modelin e rivlerësimit dhe ta zbatojë atë në mënyrë konsistente. Po ashtu, sipas paragrafit 73, politikat kontabël duhet të shpalosen qartë dhe të jenë në përputhje me trajtimin e aplikuar në praktikë. Ndërsa, SNK 1 kërkon që shënimet shpjeguese të jenë pjesë e pandashme e pasqyrave financiare dhe të ofrojnë informacion të mjaftueshëm për të mundësuar kuptimin e drejtë të elementeve të raportuara.

Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të NP Termokos për vitin 2025, është evidentuar se ndërmarrja ka aplikuar modelin e rivlerësimit për pasuritë dhe i ka paraqitur ato sipas vlerës së rivlerësuar në pasqyrat financiare. Megjithatë, politika kontabël e shpalosur në PFV vazhdon të përcaktojë se pasuritë maten sipas kostos historike, duke krijuar një mospërputhje ndërmjet politikës së deklaruar dhe praktikës së aplikuar.

Gjithashtu, shënimet shpjeguese lidhur me lejimet ndaj konsumatorëve, të cilat për vitin 2025 paraqiten në vlerë prej 15,972,790€, nga gjithsej llogari të arkëtueshme bruto prej 21,377,668€ (vlera neto 5,404,877€), nuk ofrojnë informacion të mjaftueshëm mbi metodologjinë e llogaritjes së lejimeve, ndryshimet vjetore dhe analizën e rreziqeve të arkëtueshmërisë.

Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e mos përditësimit të politikave kontabël pas ndryshimit të modelit të matjes së pasurive, si dhe ndjekjes së praktikave të mëparshme në përgatitjen e shënimeve shpjeguese, pa siguruar nivel të mjaftueshëm të shpalosjeve.

Ndikimi Këto mangësi ndikojnë në uljen e transparencës dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare, duke krijuar paqartësi për përdoruesit lidhur me bazën e matjes së pasurive. Po ashtu, ato kufizojnë mundësinë për të vlerësuar rrezikun e arkëtueshmërisë dhe saktësinë e lejimeve për borxhet e dyshimta.

Rekomandimi A3 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që menaxhmenti të përditësojë politikat kontabël në përputhje me modelin e matjes së aplikuar në praktikë. Po ashtu, duhet të përmirësohen shpalosjet në shënimet shpjeguese, duke përfshirë informacion të detajuar mbi metodologjinë e llogaritjes së lejimeve, analizën e vjetërsisë dhe vlerësimin e rreziqeve, me qëllim rritjen e transparencës dhe përputhshmërisë me standardet përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mosshpalosja dhe trajtimi jo i duhur i pasurive në pronësi dhe i kontesteve gjyqësore në PFV

Gjetja Sipas SNK 37 - Provizionet, Detyrimet e Mundshme dhe Pasuritë e Mundshme, njësia ekonomike duhet të njohë provizione për humbje të mundshme nga kontestet gjyqësore kur ekziston një detyrim aktual dhe probabiliteti i humbjes është i mundshëm të vlerësohet me besueshmëri. Në rastet kur këto kushte nuk plotësohen, detyrimet e mundshme duhet të shpalosen në mënyrë të qartë në shënimet shpjeguese. Ndërsa, sipas SNK 16, pasuritë në pronësi të njësisë ekonomike duhet të njihen dhe regjistrohen në regjistrin e asetëve kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme të rrjedhin nga përdorimi i tyre dhe kostoja e tyre mund të matet me besueshmëri. Po ashtu, sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të ofrojnë informacion të mjaftueshëm dhe transparent për të mundësuar kuptimin e drejtë të rreziqeve dhe pasigurive që lidhen me pozicionin financiar të njësisë.

Në shënimet shpjeguese të PFV, ndërmarrja ka raportuar 26 raste gjyqësore si palë paditëse dhe e paditur, me humbje të mundshme prej 600,936€ dhe fitime të mundshme prej 16,297€. Megjithatë, nuk është evidentuar nëse është kryer vlerësimi i probabilitetit të humbjes apo fitimit dhe nuk janë njohur provizione për humbjet e mundshme në përputhje me kërkesat e SNK 37.

Gjithashtu, sipas regjistrin kadastral, ndërmarrja zotëron një pronë me sipërfaqe prej 24,309 m², e cila nuk është në shfrytëzim nga ndërmarrja dhe është në përdorim nga palë të treta. Megjithatë, ndërmarrja nuk ka siguruar trajtim kontabël dhe shpalosje adekuate për këtë pasuri në pasqyrat financiare.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mungesës së politikave të qarta për trajtimin e kontesteve gjyqësore dhe pasurive joaktive. Po ashtu, mungesa e komunikimit ndërmjet njërive përkatëse ka ndikuar në mos shpalosjen e pronës, ndonëse ajo figuron në regjistrin kadastral si pronë e ndërmarrjes.

Ndikimi

Mosnjohja e provizioneve dhe mungesa e vlerësimit të probabilitetit për kontestet gjyqësore paraqet devijim nga kërkesat e SNK 37 dhe rrit rrezikun që detyrimet të mos paraqiten në mënyrë të plotë në pasqyrat financiare. Po ashtu, mungesa e trajtimit kontabël dhe shpalosjes së pasurisë në pronësi të ndërmarrjes cenon përfaqësimin e drejtë të pasurive dhe kufizon transparencën e raportimit financiar.

Si rrjedhojë, pasqyrat financiare mund të mos pasqyrojnë në mënyrë të plotë dhe të besueshme pozicionin financiar të ndërmarrjes.

Rekomandimi A4

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që menaxhmenti të vendosë procedura të qarta për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e kontesteve gjyqësore, duke njohur provizionet për humbjet e mundshme dhe duke siguruar shpalosje të plotë në përputhje me kërkesat e SNK 37. Po ashtu, duhet të sigurohet vlerësimi, trajtimi e dhe shpalosja adekuate e pasurive në pronësi të ndërmarrjes, përfshirë ato që nuk janë në shfrytëzim ose janë në përdorim nga palë të treta në përputhje me kërkesat e standardeve përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A5 - Faturimi i konsumit të përbashkët për konsumatorët pa matje në kundërshtim me metodologjinë e miratuar nga ZRRE

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, nenet 15, 47 dhe 48, “tarifat duhet të jenë të bazuara në metodologji të miratuar, të arsyeshme, transparente dhe nuk mund të aplikohen apo modifikohen pa miratimin e Rregullatorit”.

Sipas Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike ZRRE/Nr. 01/2022, neni 16, paragrafi 1, pika c), “nëse më shumë se një konsumator është i kyçur në një nënstacion (‘ndërtesat me shumë njësi’), atëherë konsumi i matur në këtë nënstacion do të shërbejë si matje bazë për faturim, ndërsa alokimi tek konsumatorët bëhet sipas metodologjisë së përcaktuar në Shtojcën 8”.

Po ashtu, sipas Shtojcës 8 - Metodologjia e alokimit të kostos së ngrohjes, pika 1.3, “metodologjia do të zbatohet për të gjitha ndërtesat me shumë njësi (kolektive), ku ka matje funksionale të ngrohjes në nivel të nënstacionit të ndërtesës dhe në nivel të njësisë.

Gjatë auditimit nga analiza e faturave të konsumatorëve është konstatuar se, konsumatorëve pa pajisje matëse u është faturuar komponenti i konsumit të përbashkët.

Nga shqyrtimi i kryer, rezulton se ky faturim nuk është zbatuar në përputhje me Rregullën ZRRE Nr.01/2022 dhe vendimet në fuqi të ZRRE-së, pasi aplikimi i konsumit të përbashkët është bërë edhe në raste kur nuk ekzistojnë pajisje matëse në nivel të njësisë, siç kërkohet nga metodologjia e përcaktuar në Shtojcën 8.

Për më tepër, Termokos ka aplikuar një metodologji të bazuar në një dokument në formë drafti, përkatësisht “Procedurën e leximit të matësve të energjisë termike/evidentimit të sipërfaqeve ngrohëse dhe faturimit të konsumatorëve tariforë”, për të cilin nuk janë ofruar dëshmi për miratim formal nga ZRRE.

Sipas të dhënave për vitin 2025, vlera totale e faturuar vetëm për “konsum të përbashkët” për konsumatorët pa matje (C33) arrin në 333,222€.

Në këtë kontekst, praktika e ndjekur nuk është në përputhje të plotë me strukturën tarifore dhe kërkesat rregullative të ZRRE.

Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e moszbatimit të plotë të metodologjisë tarifore të miratuar nga ZRRE, si dhe mungesës së kontrolleve efektive të brendshme në procesin e faturimit, duke mundësuar aplikimin e praktikave që nuk mbështeten në kornizën rregullative.

- Ndikimi** Aplikimi i faturimit të konsumit të përbashkët për konsumatorët pa pajisje matëse paraqet devijim nga kërkesat rregullative të ZRRE-së dhe metodologjia tarifore në fuqi. Kjo ndikon në nivelin e pajtueshmërisë së ndërmarrjes me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi. Po ashtu, kjo rrit rrezikun për kontestime nga konsumatorët dhe për ndërmarrjen mund të ketë implikime rregullative dhe financiare në rast të kërkesave për korrigjime nga autoriteti rregullator.
- Rekomandimi A5** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë forcimin e kontroleve të brendshme në zbatimin e plotë të metodologjisë tarifore të miratuar nga ZRRE, duke mos apliuar praktika faturimi që nuk janë të mbështetura në kornizën rregullative në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mangësi në procedurat e prokurimit

Gjetja Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 59, paragrafi 4, përcakton se autoriteti kontraktues duhet të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse ai është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Gjithashtu, njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit përcaktojnë në mënyrë të qartë kriteret teknike, profesionale dhe administrative, të cilat duhet të verifikohen në mënyrë objektive dhe të dokumentuar gjatë procesit të vlerësimit, për të siguruar trajtim të barabartë dhe konkurrencë të drejtë.

Në kuadër të procedurës së prokurimit “Punët e paparapara për ndërtimin e objektit të ri administrativ dhe renovimin e hapësirave përcjellëse të NP “TERMOKOS” Sh.A”, gjatë auditimit janë evidentuar mospërputhje ndërmjet kërkesave të dosjes së tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik fitues, si në vijim:

- Për skele lëvizëse kërkoheshin 400 m², ndërsa është dorëzuar dëshmi për 240 m²;
- Për kamion kiper me kran 3 ton kërkoheshin 2 copë, ndërsa është dorëzuar një kamion me dokumentacion të pjesshëm për regjistrim;
- Për kamion kiper kërkoheshin 1 copë, ndërsa është dorëzuar i njëjti kamion që ishte përdorur për kërkesën e mëparshme;
- Për stafin profesional kërkoheshin verifikim gjashtë (6) mujor nga ATK dhe përvoja e deklaruar në CV, ndërsa janë dorëzuar kontrata dhe dëshmi të pjesshme, me mospërputhje në periudhën dhe statusin e punës.

Gjithashtu, në procedurën e prokurimit për kontratën “Shpenzimet e shitjes dhe marketingut”, në vlerë prej 25,550€, është konstatuar se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk kishte dorëzuar dëshmi për kualifikimin profesional për dy punonjës të listuar si staf kyç, siç kërkoheshin në dosjen e tenderit, për përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mangësive në kontrollet e brendshme si në fazën e përgatitjes së dosjes së tenderit, ku kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional nuk ishin të harmonizuara ashtu edhe në fazën e vlerësimit, për shkak të verifikimit jo të plotë të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë.

Ndikimi

Mosverifikimi i plotë i përmbushjes së kërkesave të dosjes së tenderit rrit rrezikun e dhënies së kontratës operatorëve ekonomik që nuk i plotësojnë kriteret, duke cenuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë. Po ashtu, pranimi i ofertave pa dëshmi të plota për kapacitetet teknike dhe profesionale reflekton dobësi në procesin e vlerësimit dhe cenon besueshmërinë e procesit të prokurimit.

Rekomandimi A6

Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmarrë masa për forcimin e mekanizmave të kontrollit në procesin e përgatitjes së tenderit dhe vlerësimin e ofertave, me qëllim që ky proces të zhvillohet në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B6 - Vonesa në trajtimin e ankesave të konsumatorëve****Gjetja**

Procedura për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve të “NP Termokos”, neni 4 përcakton se konsumatorët kanë të drejtë të parashtrajnë ankesa lidhur me verifikimin e cilësisë së ngrohjes vetëm brenda periudhës së sezonit ngrohës (15 tetor - 15 prill). Ankesa të dorëzuara pas këtij afati nuk mund të shqyrtohen, pasi cilësia e ngrohjes nuk mund të verifikohet kur nuk funksionon ngrohja. Më tutje, neni 6, paragrafi 2 i kësaj procedure përcakton që shqyrtimi i ankesave nga furnizuesi duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike, por nuk duhet të tejkalojë afatin maksimal prej tre muajsh nga data e pranimit dhe regjistrimit të ankesës për rastet më komplekse.

Nga analizimi i ankesave të shqyrtuara, është konstatuar se në katër (4) raste ka pasur vonesa në trajtimin e tyre, duke tejkaluar afatet e përcaktuara në procedurat e brendshme. Kjo tregon se procesi i shqyrtimit të ankesave nuk është zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në përputhje me kërkesat e përcaktuara.

Mosrespektimi i afateve për trajtimin e ankesave ka ardhur si pasojë e e mungesës së kontrolleve të brendshme dhe monitorimit efektiv të këtij procesi.

Ndikimi

Vonesat në trajtimin e ankesave cenojnë pajtueshmërinë me procedurat e brendshme dhe rrezikojnë efektivitetin e procesit të verifikimit të cilësisë së shërbimit. Kjo mund të ndikojnë në saktësinë e evidencave dhe në raportimin e detyrimeve të konsumatorëve, si dhe të ulë besimin e konsumatorëve ndaj ndërmarrjes.

Rekomandimi B6 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të procesit të trajtimit të ankesave, me qëllim që ato të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me procedurat e brendshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Realizimi i kontratave pa procedura prokurimi

Gjetja Sipas të Ligjit për Prokurimin Publik të nenit 3, autoritetet kontraktuese obligohen të zhvillojnë procedura të prokurimit për kontraktimin e shërbimeve, përveç rasteve të përjashtuara me ligj. Po ashtu, sipas nenit 6 dhe 7 të këtij ligji, autoritetet kontraktuese duhet të sigurojnë transparencë, konkurrencë dhe përdorim efikas të fondeve publike gjatë kontraktimit të shërbimeve.

Gjatë auditimit është evidentuar se në vitin 2025 janë realizuar pagesa në shumën prej 50,400€ për gjashtë (6) kontrata për “Shfrytëzimin e hapësirave reklamuese në media online/portale”, të cilat ishin lidhur gjatë vitit 2024. Këto kontrata nuk ishin zhvilluar përmes procedurave të parapara me Ligjin për Prokurimin Publik, por përmes shpalljes publike jashtë platformës zyrtare të sistemit për prokurimin publik. Megjithatë, përkundër faktit që është ndjekur një procedurë e shpalljes publike, nuk na janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentet përkatëse, duke kufizuar mundësinë tonë për të vlerësuar në mënyrë të plotë procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e përfituesve.

Për më tepër, për këtë qëllim, gjatë vitit 2025 është lidhur edhe një kontratë e re për “Shpenzime të shitjes dhe marketingut” në vlerë prej 25,550€, e cila është zhvilluar përmes procedurave të rregullta të prokurimit.

Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e moszbatimit të kërkesave ligjore për zhvillimin e procedurave të prokurimit, si dhe mungesës së kontrolleve efektive të brendshme për të siguruar që kontraktimi i shërbimeve të realizohet përmes procedurave të parapara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Ndikimi Mos zhvillimi i procedurave për kontraktimin e shërbimeve në përputhje me kërkesat ligjore paraqet devijim nga korniza rregullative dhe rrit rrezikun e cenimit të transparencës dhe konkurrencës. Kjo ndikon në sigurimin e përdorimit efikas në sigurimin e përdorimit efikas të fondeve publike dhe në arritjen e vlerës më të mirë për parandë.

Rekomandimi A7 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që kontraktimi i shërbimeve të realizohet përmes procedurave të prokurimit, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke forcuar mekanizmat e kontrollit për të garantuar pajtueshmërinë me kornizën ligjore dhe rregullative.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit të pasurive dhe mjeteve me regjistrat kontabël**Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, shoqëritë tregtare janë të obliguara që të verifikojnë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit përmes procesit të inventarizimit dhe të harmonizojnë rezultatet e inventarizimit me regjistrat kontabël.

Ndërsa sipas SNK 2, stoqet duhet të vlerësohen në kosto ose në vlerën neto të realizueshme dhe çdo zhvlerësim duhet të regjistrohet si shpenzim në periudhën përkatëse.

Ndërmarrja nuk kishte kryer fare harmonizimin ndërmjet gjendjes së konstatuar nga komisionet e inventarizimit dhe gjendjes së pasurive të regjistruara në regjistrat kontabël, me përjashtim të stokut, për të cilin ishte bërë harmonizimi.

Sa i përket stokut, nga raporti i komisionit të inventarizimit është konstatuar se vlera reale e stokut në depo ishte më e ulët krahasuar me regjistrat kontabël për shumën prej 86,495€. Megjithatë, në sistem është gjeneruar një regjistrim automatik me efekt debi në vlerë prej 154,658 €, i cili nuk përputhet me diferencën reale të identifikuar.

Edhe pse pas harmonizimit gjendja e stokut rezulton e përputhur me inventarin fizik, regjistrimi kontabël i evidentuar nuk pasqyron saktë diferencën reale. Gjithashtu, gjenerimi i këtij regjistrimi automatik tregon dobësi në kontrollet mbi rregullimet e krijuara nga sistemi financiar gjatë procesit të harmonizimit të stokut.

Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e planifikimit jo të mjaftueshëm të procesit të inventarizimit dhe mungesës së kontrolleve efektive për harmonizimin në kohë të pasurive me regjistrat kontabël.

Ndikimi

Mosrealizimi i harmonizimit të regjistrit të pasurive dhe mjeteve me raportet e komisioneve të inventarizimit si dhe regjistrimi i pasaktë i diferencave të stokut dhe mungesa e verifikimit të regjistrimeve të gjeneruara automatikisht nga sistemi, rrit rrezikun që evidencat kontabël të mos pasqyrojnë saktë gjendjen reale të pasurive. Kjo, ndikon në besueshmërinë e informacionit financiar dhe në prezantimin e drejtë të pasurive në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B7

Bordi i Drejtorëve të sigurojë që rezultatet e inventarizimit të harmonizohen me regjistrat kontabël për të gjitha kategoritë e pasurive si dhe çdo diferencë e identifikuar gjatë inventarizimit të reflektohet saktë në regjistrat kontabël dhe në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Mungesë e formalizimit kontraktual për të gjithë konsumatorët dhe mungesa e emërimit të konsumatorëve**Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 05/L-052 për energjinë termike, Neni 20 furnizuesi publik është i obliguar të lidhë kontrata me konsumatorët në përputhje me rregullat e nxjerra nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), për të gjithë konsumatorët që plotësojnë kushtet, duke përfshirë edhe identitetin e pronarit ose të autorizuarit që shfrytëzon energjinë termike.

Ndërmarrja, edhe gjatë vitit 2025, nuk ka arritur të lidhë kontrata me të gjithë konsumatorët që furnizohen me energji termike. Sipas regjistrimit të konsumatorëve, ndërmarrja ka gjithsej 25,597 konsumatorë aktivë, ndërsa kontrata të lidhura janë vetëm për 15,638 prej tyre.

Për më tepër, në regjistrin e konsumatorëve janë identifikuar raste me mungesë identifikimi të plotë të klientëve, ku 24 konsumatorë janë të evidentuar me përshkrimin "N.N". Kjo tregon se evidencat e konsumatorëve nuk janë të plota dhe nuk sigurojnë identifikim të saktë për të gjithë përfituesit e shërbimeve.

Mos lidhja e kontratave me të gjithë konsumatorët aktivë lidhet me mungesën e bashkëpunimit nga ana e konsumatorëve për nënshkrimin e kontratave ndër vite. Ndërsa evidencat me përshkrimin "N.N" kanë ardhur si pasojë e identifikimit jo të plotë të konsumatorëve dhe mungesës së përditësimit sistematik të të dhënave, pavarësisht se një pjesë e tyre janë identifikuar.

Ndikimi

Mungesa e kontratave dhe evidencave të plota për konsumatorët, paraqet devijim nga kërkesat ligjore, dhe kufizon mundësinë e ndërmarrjes për të ndërmarrë masa ndaj konsumatorëve në rast të mos shlyerjes së detyrimeve. Po ashtu, ndikon në besueshmërinë e evidencave të konsumatorëve dhe raportimit financiar.

Rekomandimi B8

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjithë konsumatorët që përfitojnë shërbime nga ndërmarrja të pajisen me kontrata të vlefshme në përputhje me kërkesat e ZRRE-së. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime për plotësimin dhe përditësimin e evidencave të konsumatorëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A8 - Mungesa e dokumentacionit mbështetës në dosjen e rekrutimit****Gjetja**

Sipas Udhëzimit Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik neni 14, kandidatët që kalojnë verifikimin paraprak të aplikacioneve i nënshtrohen testimit me shkrim si pjesë e obligueshme e procesit të rekrutimit. Ndërsa sipas nenit 26.3 përgjatë procesit të konkursit publik njësia përkatëse e burimeve njerëzore bën përpunimin e të dhënave të kandidatëve dhe ofron mbrojtje e këtyre të dhënave në përputhje me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të rekrutimit për pozitën "Referent për kontroll të pagesës / terren", nuk janë siguruar të gjitha dokumentet e procedurës, përkatësisht dëshmitë e testit me shkrim të administruar për kandidatët. Si rezultat, nuk ishte e mundur të vlerësohej nëse procesi i testimit me shkrim është zhvilluar dhe vlerësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës.

Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e mos zbatimit të plotë të kërkesave të kontrollit të brendshëm për dokumentimin e plotë, gjatë dhe pas përfundimit të procesit të rekrutimit.

Ndikimi Mungesa e dokumentacionit pamundëson verifikimin e korrektësisë dhe transparencës së procesit të rekrutimit. Kjo cenon besueshmërinë e procesit dhe rrit mundësinë për parregullsi në përzgjedhjes e stafit.

Rekomandimi A8 Bordi i Drejtorëve të sigurojë përforcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm për të siguruar që çdo fazë e procesit të rekrutimit të dokumentohet dhe të ruhet në dosjen përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e transparencës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Lidhja e kontratave operative pa bazë të qartë autorizuese dhe njohja e avanseve mbi pagesat reale.

Gjetja Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Termokos SHA për projektin "Solar4Kosovo", roli i Termokos-it është përcaktuar si financues dhe raportues i shpenzimeve, pa përfshirë përfaqësim kontraktual apo marrje të obligimeve direkte ndaj palëve të treta.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-077 për Detyrimet, neni 130, kontrata krijon të drejta dhe detyrime vetëm për palët kontraktuese, ndërsa sipas nenit 72, veprimet juridike në emër të një pale tjetër mund të kryhen vetëm përmes përfaqësimit të autorizuar.

Gjithashtu, sipas Kornizës Konceptuale për Raportim Financiar dhe kërkesave të IAS 1, transaksionet duhet të paraqiten në përputhje me substancën e tyre ekonomike dhe jo vetëm formën ligjore.

Termokos SHA, ndonëse sipas marrëveshjes bazë me Komunën e Prishtinës ishte përcaktuar vetëm si financues dhe raportues i shpenzimeve që lidhen me obligimet e Komunës së Prishtinës për projektin “Solar4Kosovo”, ka lidhur kontratë në vlerë 658,445€ me Ndërmarrjen Publike Banesore, duke marrë përsipër obligime të drejtpërdrejta kontraktuale dhe financiare.

Në marrëveshjen bazë nuk janë përcaktuar qartë shuma dhe mënyra e financimit, si dhe nuk është paraparë roli i Termokos-it si palë kontraktuese apo përfaqësuese. Përkundër kësaj, ndërmarrja ka vepruar si palë kontraktuese.

Në aspektin kontabël, ndërmarrja ka njohur mjete si avans ndaj Komunës së Prishtinës, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme është reflektuar si detyrim ndaj palës së tretë, duke treguar se në substancë ka marrë obligime direkte.

Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e interpretimit të marrëveshjes me Komunën e Prishtinës si bazë të mjaftueshme për lidhjen e kontratave operative, si dhe e mungesës së vlerësimit adekuat të rolit të ndërmarrjes në këto transaksione.

Ndikimi

Kjo ka rezultuar në marrjen e obligimeve kontraktuale pa bazë të qartë autorizuese, duke rritur rrezikun ligjor dhe financiar për ndërmarrjen, si dhe duke krijuar paqartësi në paraqitjen e rolit të saj në raportimet financiare.

Rekomandimi A9

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që marrëveshjet ndërinstitucionale të përcaktojnë qartë rolet, kufijtë e përgjegjësive dhe mekanizmat e financimit, si dhe të mos ndërmarrë obligime kontraktuale pa autorizim të qartë. Gjithashtu, duhet të sigurohet që trajtimi kontabël i transaksioneve të reflektojë substancën e tyre ekonomike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Llogaritë e arkëtueshme

Vlera e llogarive të arkëtueshme, e prezantuar në PFV ishte 5,404,876€ (vlera neto). Ato kanë të bëjnë me arkëtimet ndaj klientëve nga afarizmi i rregullt i ndërmarrjes.

Çështja B9 - Mungesë e identifikimit të pagesave nga konsumatorët e painedifikuara

Gjetja

Sipas SNK 1 “Pasqyrat financiare duhet të paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar, duke siguruar përfaqësim të besueshëm të transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike. Ndërsa sipas Kornizës Konceptuale të SNRF-ve, informacioni financiar duhet të jetë i besueshëm dhe i plotë, duke reflektuar saktë substancën ekonomike të transaksioneve, përfshirë regjistrimin dhe alokimin korrekt të arkëttimeve.

Arkëtimet nga konsumatorët në vlerë prej 37,849€ nuk janë alokuar te klientët përkatës, por janë regjistruar në evidencat kontabël si “llogari të arkëtueshme të painedifikuara”. Si rrjedhojë, këto pagesa nuk kanë ndikuar në zvogëlimin e obligimeve të konsumatorëve përkatës, duke rezultuar në mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme. Për më tepër, mbajtja e këtyre shumave si të painedifikuara, nuk pasqyron në mënyrë të saktë obligimet reale të konsumatorëve.

Kjo kategori ka shënuar rritje prej 12,015€ krahasuar me vitin paraprak, duke reflektuar mungesë të trajtimit sistematik të këtyre arkëttimeve dhe dobësi në proceset e identifikimit dhe rakordimit të pagesave me klientët përkatës.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i vështirësive në identifikimin e konsumatorëve që kanë kryer pagesat përmes llogarive bankare, kryesisht për shkak të përshkrimeve të paqarta ose jo të plota në referencat e pagesave, si dhe mungesës së mekanizmave efektivë për ndërlidhjen e këtyre pagesave me klientët përkatës.

Ndikimi

Mos identifikimi i saktë i pagesave rrit rrezikun për vendimmarrje jo të saktë dhe keqmenaxhim të arkëttimeve. E gjithë kjo ndikon në paraqitjen jo të drejtë të llogarive të arkëtueshme dhe obligimeve në pasqyrën e pozicionit financiar.

Rekomandimi B9

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë alokimin e saktë dhe në kohë të arkëttimeve te klientët përkatës, përmes forcimit të kontrolleve të brendshme, vendosjes së procedurave të qarta dhe rakordimeve periodike të llogarive të painedifikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të Termokos, ka rezultuar në 18 rekomandime kryesore. Menaxhmenti i ndërmarrjes ka përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, dy (7) rekomandime ishin zbatuar, nëntë (9) ende nuk ishin zbatuar si dhe dy (2) ishin në proces të (1) zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën vijuese.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë regjistrimin e saktë të granteve me qëllim të prezantimit të saktë të të hyrave të shtyra dhe atyre të njohura nga zhvlerësimi si dhe sigurimin e dëshmimeve përkatëse për të gjitha pasuritë e financuara nga grantet.	Edhe këtë vit janë identifikuar mangësi në trajtimin e të hyrave të shtyra nga grantet.	Nuk ka filluar zbatim
2.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë regjistrimin e të gjitha pasurive duke respektuar standardet kontabël për pasuritë e paluajtshme. Për pronat që nuk kanë dëshmi të pronësisë, duhet të kryhet një verifikim ligjor dhe të ndërmerren masa për sigurimin e dokumentacionit përkatës.	Janë bërë disa veprime në adresimin e disa çështjeve të ngritura te kjo gjatje siç është regjistrimi i tokave dhe objekteve, mirë po edhe në këtë vit kemi hasur mangësi në regjistrimin e pasurive.	Pjesërisht i zbatuar

3.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të merren veprimet e nevojshme korigjuese duke bërë rishpërndarjen e kostove të kapitalizuara sipas pasurive konkrete, dhe të rishikohet zhvlerësimi dhe vlera neto e tyre.	Edhe në këtë vit gjendja është e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të zërave të cilët kanë ndikuar në pasqyrën e rrjedhjes së parasë në mënyrë që PFV të prezantojnë një gjendje të drejtë dhe të vërtetë.	Edhe këtë vit janë identifikuar gabime të rrjedha e parasë ndonëse ato nuk ishin të natyrës së njejtë sikurse në vitin e kaluar	Pjesërisht i zbatuar
5.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që, regjistri i detyrimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve.	Ndërmarrja nuk ka trajtuar ekzistencën dhe vlerësimin e detyrimeve përmes procesit të inventarizimit dhe nuk ka arritur të sigurojë dëshmi përkatëse për të gjitha diferencat lidhur me llogaritë e pagueshme.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që do të ndërmerren veprimet për të shqyrtuar diferencat e llogarive të arkëtueshme në mënyrë që raportimi financiar të jetë i saktë dhe i besueshëm.	Edhe gjatë këtij viti janë identifikuar mospërputhje ndërmjet pasqyrave financiare dhe regjistrimeve kontabël	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet korigjuese të nevojshme, në mënyrë që informacioni i llogarive të arkëtueshme si dhe prezantimi i tyre në pasqyrat financiare të jetë i saktë dhe i drejtë.	Ndërmarrja nuk ka arritur të trajtoj llogarinë me përshkrimin "Borxh i ngrirë" e cila gjendet në kuadër të llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që procesi i rivlerësimit të pasurive të ndërmarrjes të finalizohet dhe rezultatet e rivlerësimit të reflektohen në pasqyrat financiare me qëllim të prezantimit të vlerës së drejtë të tyre në PFV.	Ndërmarrja kishte angazhuar një kompani të specializuar për të kryer rivlerësimin e asetëve dhe ka përfunduar këtë proces gjatë vitit 2025.	I zbatuar

9.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë dëshmitë që vërtetojnë vlerën e plotë të pasurive të regjistruara në regjistrin kontabël, të cilat rrjedhimisht prezantohen edhe në pasqyrat financiare vjetore.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit aktual.	I zbatuar
10.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë korigjimin e rezervës së rivlerësimit sipas kërkesave të standardeve, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë.	Rekomandimi ka të bëjë me prezantimin e rezervës së rivlerësimit për një pjesë të pasurisë, i cili ishte kryer në vitin 2005. Megjithatë, kjo pasuri i është nënshtruar një rivlerësimi të ri në vitin 2025 dhe është paraqitur rezerva e re e rivlerësimit. Rrjedhimisht, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.	I zbatuar
11.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e duhura për të identifikuar konsumatorët të cilët i kanë kryer pagesat e grumbulluara në llogarinë "Llogaritë e arkëtueshme të paidentifikuara" dhe se klientëve të identifikuar, u janë zbritur obligimet ndaj ndërmarrjes.	Edhe gjatë këtij viti janë identifikuar pagesa të kësaj natyre, duke reflektuar vazhdimësi të kësaj praktike dhe duke theksuar nevojën për forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe trajtimin e duhur të tyre.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të dhënat analitike për llogaritë e arkëtueshme të jenë të sakta, duke siguruar që njohja e të hyrave nga arkëtimet e klientëve të provizionuar dhe e shpenzimeve nga provizionet të bëhet në përputhje me kërkesat e standardeve.	Gjetja lidhur me të hyrat e provizionuara mbi bazën e të dhënave jo të sakta është rregulluar gjatë këtij viti. Rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar

13.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që procesi i regjistrimit të transaksioneve që ndërlidhën me të arkëtueshmet dhe avancet tjera, të bëhet në mënyrën e duhur për të siguruar prezantim të saktë të tyre në pasqyrat financiare.	Procesi i regjistrimit të arkëtueshmeve dhe avancave është rregulluar dhe tani pasqyron informacion të saktë në pasqyrat financiare.	I zbatuar
14.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë dëshmitë përkatëse në lidhje me detyrimet e tjera si dhe të bëhen harmonizime të rregullta në mënyrë që detyrimet të prezantohen saktë në pasqyrat financiare.	Nuk kemi hasur raste të në vitin aktual.	I zbatuar
15.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që shënimet shpjeguese të ofrojnë informacion lidhur me investimet e realizuara përmes projekteve të financuara nga donatorët, në përputhje me kërkesat e standardeve të kontabilitetit, për të garantuar transparencë dhe paraqitje të drejtë të pasqyrave financiare.	Ndërmarrja ka përfshirë të dhënat e financimit të projektit "Prishtina HeatSave" në sistemin e brendshëm financiar dhe ka ndikuar në përfshirjen e tyre edhe në PFV.	I zbatuar
16.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë procedura të qarta dhe të matshme të trajtimit të ankesave të konsumatorëve.	edhe gjatë vitit 2025, ndërmarrja ka trajtuar ankesat e konsumatorëve, me disa raste të përpunuara me vonesë, dhe në disa raste ka kryer fshirje të borxheve pa dokumentacion të plotë dhe pa ndjekur procedurat e brendshme, duke treguar zbatim jo të qëndrueshëm të proceseve.	Nuk ka filluar zbatimimi

17.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që procesi i inventarizimit të bëhet në mënyrë të rregullt para dorëzimit të pasqyrave financiare, në mënyrë që rezultatet e regjistrimeve të fundvitit të harmonizohen me regjistrat kontabël dhe diferencat eventuale të reflektohen edhe në pasqyra financiare.	Ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizimin e plotë të të dhënave ndërmjet kontabilitetit dhe regjistrit të inventarizimit të stoqeve dhe pasurive.	Nuk ka filluar zbatimin
18.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të gjithë klientët të cilët përfitojnë shërbime nga ndërmarrja, të kenë të lidhur kontratën për furnizim me energji termike sipas rregullave të ZRRE-së.	Ndërmarrja kishte ndërmarrë veprime: si dërgimi i vërejtjeve me shkrim të konsumatorët, si dhe njoftime kolektive në objekte banesore, por nuk kishte arritur të sigurojë nënshkrimin e kontratave me konsumatorët në tërësi.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Ardiana Selimaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Letër konfirmimi



NDËRMARRJA PUBLIKE / PUBLIC ENTERPRISE - JAVNO PREDUZEĆE

TERMOKOS SH.A.
D.D.

Prishtinë-PRISHTINË-PRISHTINË
Nr. 855 Pr. 28.04.2026

Ngrohtorja e qytetit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese në emër të Bordit të Drejtorëve, konfirmoj se:

- Kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ndërmarrjes Publike "Termokos" Sh.a., për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohemi me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kemi ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ua dorëzojmë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Znj. Shukrije Morina
Kryesuese e Bordit të Drejtorëve

Data: 28 prill 2026, Prishtinë



Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

Në bazë të nenit 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III/Nr. 31/15 QERSHOR 2008, në pajtim me normat tjera pozitive relevante, Bordi i Drejtorëve të NP "Termokos" Sh.a, Prishtinë, me datën 11.03.2026 merr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet Dokumenti: Pasqyrat Vjetore Financiare të NP "Termokos" sh.a, Prishtinë, për vitin 2025
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

Arsyetim

Në takimin e dt. 11.03.2026, Bordi i Drejtorëve të NP "Termokos" sh.a, Prishtinë, ka shqyrtuar dokumentet: draft- Pasqyrat Vjetore Financiare të NP "Termokos" sh.a, Prishtinë, për vitin 2025 të përgatitur nga Menaxhmenti i Ndërmarrjes.

Paraprakisht, dokumenti është trajtuar nga Komisioni i Auditimit të Ndërmarrjes, ku është dhënë aprovimi duke raportuar në Bord.

Bordi i Drejtorëve ka analizuar dokumentin në mënyrë kronologjike dhe përmbajtësore dhe në mënyrë unanime ka vendosur si në dispozitiv të këtij.


Të dorzohet:

Arkivës
Komisionit Komunal të Aksionarëve
Publik

Kryesues i Bordit të Drejtorëve të NP Termokos Sh.A

Visar Vokri





Termokos

Ngrohtorja e qytetit

NDËRMARRJA PUBLIKE-PUBLIC ENTERPRISE-JAVNO PREDUZEĆE
TERMOKOS SH.A.
J.S.C.
D.D.
PRISHTINË-PRISHTINA-PRISTINA
Nr. 557/1 Dt. 11.03 2026.

N.P. "TERMOKOS" SH.A.

Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA:

Deklarata e pajtueshmerisë.....	3
Pasqyra e pozicionit financiar.....	4
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse.....	5
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.....	6
Pasqyra e rrjedhjes së parasë.....	7
1. Informata të përgjithshme.....	8
2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare.....	9
3. Paraja dhe ekuivalentet e parasë.....	13
4. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera.....	14
5. Stokset.....	14
6. Pasuritë tjera afatshkurtëra.....	14
7. Prona, Pajisjet dhe Makineritë.....	15
8. Llogarit e pagueshme tregtare dhe tjera.....	15
9. Kreditë dhe huatë, pjesa aftashkurtër.....	15
10. Detyrimet tjera afatshkurtëra.....	16
11. Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë.....	16
12. Detyrimet tjera afatgjata.....	17
13. Provizionet afatgjata.....	17
14. Fitimet e mbajtura	18
15. Të hyrat	18
16. Kostoja e Shitjes.....	19
17. Të ardhurat tjera.....	19
18. Shpenzimet e Shpërndarjes.....	19
19. Shpenzimet administrative.....	20
20. Shpenzimet e zhvlerësimit.....	21
21. Shpenzimet tjera.....	21
22. Shpenzimet financiare.....	21
23. Shpenzimet e tatimit në fitim.....	22
24. Transaksionet me palët e lidhura.....	22
25. Menaxhimi i rrezikut financiar.....	23
26. Kontigjencat dhe zotimet.....	25
27. Ngjarjet pas datës së raportimit.....	25

N.P "TERMOKOS" SH.A.
DEKLARATA E PAJTUESHMERISË
Me 31 dhjetor 2025

Deklaratë e Pajtueshmërisë


Për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2025 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e *Ligjit 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.*

U.D. Kryeshefi Ekzekutiv
N.P. "TERMOKOS" SH.A.
Kastrjot Bllaca




(emri, mbiemri, nënshkrimi)



Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit

Arton Shabani



(emri, mbiemri, nënshkrimi)

(Prishtinë, 11 mars 2026)

N.P "TERMOKOS" SH.A.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
 Me 31 dhjetor 2025
 Të gjitha shumat në Euro

Pershkrimi	Shënimi	2025 €	2024 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	314,374	1,693,660
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	4	5,404,877	4,611,550
Stoqet	5	1,001,540	899,033
Pasuritë tjera afatshkurtëra	6	1,067,172	112,334
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		7,787,962	7,316,576
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	7	72,663,784	49,357,584
Investimet në vijim		5,080,580	2,351,247
Gjithsej pasuritë afatgjata		77,744,363	51,708,831
Gjithsej pasuritë		85,532,326	59,025,407
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	2,747,511	1,705,125
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurter	9	654,000	463,000
Detyrimet tjera afatshkurtëra	10	1,472,189	1,114,566
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		4,873,700	3,282,691
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	11	-	409,000
Provizionet afatgjata	12	-	77,590
Detyrimet e tjera afatgjata	13	42,240,159	33,682,333
Gjithsej detyrimet afatgjata		42,240,159	34,168,923
Gjithsej detyrimet		47,113,859	37,451,614
EKUITETI			
Kapitali aksionar		25,000	25,000
Fitimet e mbajtura	14	21,727,442	21,548,793
Rezerva e rivleresimit		16,666,024	-
Gjithsej ekuiteti		38,418,466	21,573,793
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		85,532,326	59,025,408

Pasqyrat financiare janë draft të cilat priten të aprohen nga Bordi i N.P. Termoko Sh.A. dhe priten të nënshkruhen pas miratimit më datë 11 mars 2026 në emër të:


Kastriot Billaca
 U.D Kryeshef Ekzekutiv




Arton Shabani
 Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit

Shënimet e bashkangjitura në faqet 8 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

Pershkrimi	Shënimi	2025	2024
		€	€
Të hyrat	15	11,864,692	12,330,205
Kostoja e shitjes	16	(3,020,999)	(2,527,192)
Fitimi / (humbja) bruto		8,843,692	9,803,013
Të ardhurat tjera	17	2,874,462	2,549,816
Shpenzimet e shperndarjes	18	(3,917,507)	(3,635,767)
Shpenzimet administrative	19	(798,550)	(576,387)
Shpenzimet e zhvlerësimit	20	(4,093,107)	(3,298,152)
Shpenzimet e tjera	21	(1,125,925)	(1,959,799)
		(7,060,628)	(6,920,288)
Fitimi / (humbja) operativ		1,783,064	2,882,724
Shpenzimet financiare	22	(237,793)	(111,696)
Të ardhurat financiare			
Fitimi / (humbja) para tatimit		1,545,271	2,771,029
Shpenzimet e tatimit në fitim	23	(208,988)	(300,000)
Fitimi / (humbja) i/e vitit		1,336,283	2,471,029
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit		-	-
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfsh. të vitit		1,336,283	2,471,029

Shënimet e bashkangjitura në faqet 8 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

N.P "TERMOKOS" SH.A
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat Euro

Pasqyra e e ndryshimeve në ekuitet për periudhen që përfundon më 31 Dhjetor 2025				
Pershkrimi	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2024	25,000	18,142,390	0	18,167,390
Fitimi / (humbja) i/e vitit		2,471,029		2,471,029
Korigjimet e viteve paraprake		935,374		935,374
				-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	25,000	21,548,793	-	21,573,793
				-
Fitimi / (humbja) i/e vitit		1,336,283		1,336,283
Korigjimet e viteve paraprake		(1,157,634)		
Rezerva e rivleresimit - Toka			10,673,080	
Rezerva e rivleresimit - Objektet & Pajisje			5,992,944	
Gjendja më 31 dhjetor 2025	25,000	21,727,442	16,666,024	38,418,466

Shënimet e bashkangjitura në faqet 8 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

N.P "TERMOKOS" SH.A.
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat Euro

Pasqyra e rrjedhjes së parasë për periudhen që përfundon më 31 Dhjetor 2025		
Pershkrimi	2025	2024
	€	€
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	1,336,283	2,471,029
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpen. dhe të hyrave</i>		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	4,093,107	3,298,152
Shpenzimet financiare	(3,112,254)	(2,549,816)
Fitimi / (humbja) nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve		111,696
Shpenzimet e tatimit në fitim	(208,988)	300,000
	2,108,148	3,631,061
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		
(Rritja)/zvogëlim në llog. e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(793,327)	(1,087,795)
Rritja / (zvogëlimi) të stoqet	(102,507)	(52,316)
Rritja / (zvogëlimi) të pasuritë tjera afatshkurtëra	(954,838)	
Rritja / (zvogëlimi) në llog. e pagueshme tregtare dhe të tjera	1,042,386	141,569
Rritja / (zvogëlimi) të detyrimet tjera	357,623	
	(450,663)	(998,542)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	1,657,484	2,632,519
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(2,741,180)	(4,542,541)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	(2,741,180)	(4,542,541)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë/grantet		
Ripagimi i kredive dhe huave	(295,590)	(463,000)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	(295,590)	(463,000)
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë	(1,379,286)	(2,373,023)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	1,693,660	4,066,683
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	314,374	1,693,660

Shënimet e bashkangjitura në faqet 8 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informata të përgjithshme

N.P." Termokos" SH.A në Prishtinë është rexhistruar si shoqëri aksionare më 26.12.2005 pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë me numer të rexhistrimit të biznesit 70325346 me adresë: Dardania P.n

Kompanija është trashëgimtarë Ligjor i NPK" Termokos" Sh.a për regjionin e Prishtinës, si shoqëri aksionare ka filluar të operoj më 01.01.2005 me bilancin e hapjes me korporatizimin e Kompanive Publike.

Veprimtaria e ndërmarrje është:

- a. Furnizimi me avull dhe ajër të kondicionuar

Qëllimi kryesor i kompanis është prodhimi shpërndarja dhe furnizimi me energji ngrohëse me shërbime të cilat janë të rregulluara nga Zyra Rregullative e Energjisë në përputhje me ligjin mbi rregullimin e Energjisë. Në pajtim me këto kushte kompania është e paisur me Licencë nga rregullatori për prodhimin, shpërndarjen, dhe furnizimin me energji ngrohëse.

Kapitali fillestar I regjistruar në librat e kompanisë është në shumën prej 25,000 euro, librat e kompanis janë të hapura më 01 Janar 2005 sipas Raportit financiar të kujdesit "Due Diligence" lëshuar nga konzorciumi i përbërë prej Deloitte Centrale Europe Limited, Ëolf Theiss, Raiffeiseninvestgmet dhe American Appraisal Hungary, dhe rezultati i vlerësimit i lëshuar nga vlersësues të pavarur të kualifikuar American Appraisal Hungary.

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 plotsim ndryshimit të ligjit nr. 04/L-111 për ndërmarrjet publike. N.P." TERMOKOS" SH. A udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv i cili i përgjigjet drejtpërdrejt Bordit të Drejtorëve, i cili Bord i raporton Komisionit të Aksionarëve të caktuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës në përbërje prej dy antarëve dhe një i emëruar nga Kryetari i Komunës së Prishtinës.

Me 31 Dhjetor 2025 numri i punëtorëve është 259 duke përfshir Bordin e Ndërmarrjes, Komisionin Komunal të Aksionarëve, ndersa me 31 Dhjetor 2024 ishin 260.

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar.

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur nën koventën e kostos historike. Bazat e matjes janë përshkruar më detajisht në politikat e kontabilitetit më poshtë.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara të kontabilitetit. Gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave të kontabilitetit të Kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, shpalosen në Shënimin 3.n).

c) Valuta funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë përgatitur si dhe për vitet që përfundojnë më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 Të dhënat aktuale dhe krahasuese në këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, e cila është gjithashtu valuta funksionale e Kompanisë.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-në kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

COVID-19: Zhvillimi i shpejtë i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Kosovë dhe globalisht mund të rezultojë në supozime dhe vlerësime që kërkojnë rishikime të cilat kërkojnë rregullime materiale të vlerësimit të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti menaxhmenti pret që supozimet dhe vlerësimet e përdorura në përcaktimin e pasurive të patrupëzuara pronës dhe pajisjeve pasurive me të drejtë përdorimi llogarive të arkëtueshme dhe të arkëtueshme tjera huamarrjeve llogarive të pagueshme dhe të pagueshme tjera dhe vlerësimit të tyre mund të kërkojnë korigjim. Mirëpo në këtë fazë menaxhmenti nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme ndikimin pasi ngjarjet po rrjedhin dita-ditës. Ndikimi afatgjatë mund të ketë ndikim edhe në të ardhurat flukset e parave dhe profitabilitetin. Sidoqoftë në datën e këtyre pasqyrave financiare kompania vazhdon të përmbushë detyrimet e saj dhe prandaj vazhdon të zbatojë bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare sipas parimit të vijimësisë.

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

e) Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat e pozitës financiare dhe ajo e të Ardhurave janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë që supozon që kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe të mbulojë detyrimet gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Politika të rendësishme kontabël

a) Prona dhe paisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë paraqitur sipas kostos minus zhvlerësimit të akumuluar dhe humbjeve nga dëmtimet.

Kosto përfshinë shpenzimet të cilat i atribuohen direkt blerjes së pasurisë.

Kur pjesët e një zëri të pronës impianteve dhe pajisjeve kanë jetë të ndryshme të përdorimit ato trajtohen si zëra të veçantë (komponenta kryesore) të impianteve dhe pajisjeve.

Një zë i pronës dhe pajisjeve gregjistrohet në rast se shitet ose kur nuk ka përfitime të ardhme ekonomike që pritet të lindin nga përdorimi i vazhdueshëm i pasurisë. Çdo fitim ose humbje që krijohet me rastin e shitjes së një zëri të pronës impianteve dhe pajisjeve përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të pasurisë dhe njihet në fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese të pronës dhe pajisjeve njihet sipas vlerës bartëse të zërit nëse përfitimi i ardhshëm ekonomik i integruar mbrenda pjesës së pasurive është i mundshëm të rrjedhë në kompani dhe kosto e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të pronës dhe pajisjeve nga dita në ditë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas metodës lineare përgjatë jetës së vlerësuar të përdorimit të pasurive. Metodatat e zhvlerësimit jetët e përdorimit dhe vlerat e mbetura (nëse nuk janë domethënëse) rivlerësohen në datën e raportimit.

Jetët e vlerësuara të përdorimit për periudhat e tanishme dhe krahasuese ishin siç vijon;

Përshkrimi	Vite
Ndërtesa dhe rrjeti i ngrohje	20
Mjete transporti për punë	5 deri 10
Makineri e vegla pune	5 deri 7
Pajisje informatike & Softëare	5
Mobilje e orendi	5

Në bazë të shtesave dhe hudhjeve gjatë vitit, zhvlerësimi ngarkohet prej muajit të blerjes deri te muaji përkatës i asgjësimit.

Jetët e vlerësuara të përdorimit, vlerat e mbetura dhe metodatat e zhvlerësimit rishikohen në çdo fund vit, me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësimet kontabël në të ardhmen.

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

Fitmi ose humbja që vjen nga hudhja apo asgjësimi të ndonjë pjese të pronave, impianteve ose paisjeve përcaktohet si një diferencë në mes të të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të një asemi dhe është e njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe humbjeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

Kostot pasuese përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si pasuri e ndarë, sipas rastit, sipas nevojës, vetëm atëherë kur është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen të lidhura me atë artikull do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të sigurt. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera paraqiten në pasqyrën e ardhurave ose humbjeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

b) Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Të arkëtueshmet tregtare regjistrohen fillimisht në shumën e arkëtueshme kundrejtë shitjes së produkteve. Në vazhdimësi, llogaritë e arkëtueshme paraqiten me koston e tyre nominale duke i zbritur provizionet për borxhet e dyshimta.

Lejimi për borxhet e dyshimta njihet kur ka dëshmi objektive që një arkëtueshmëri e caktuar është e dëmtuar.

c) Llogaritë e pagueshme tregtare

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar.

d) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartmonedhat dhe monedhat në qarkullimbancat e pakufizuara që mbahen në kompaniat qëndrore dhe pasuritë që janë shumë likuide me maturitet fillestar më pak se tre muajtë cilat i nënshtrohen rrezikut të parëndësishëm të ndryshimit në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga kompania në menaxhimin e zotimeve afatshkurtëra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen sipas koston së amortizuar në pasqyrën e pozitës financiare.

e) Njohja e të ardhurave

Te ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së marre ose që është për t'u marre nga shitja e shërbimeve apo mallrave gjatë aktivitetit të zakonshëm të Kompanisë. Te ardhurat paraqiten neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kthimet dhe uljet. Te ardhurat njihen kur risqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë e mallrave janë transferuar tek blerësi, shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

g) Transkasionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta tjera që ndryshojnë nga valuta funksionale e kompanisë regjistrohen në kurset e këmbimit që mbizotërojnë në datën e transaksionit. Në çdo periudhë raportuese zërat monetarë në valutë të huaj konvertohen në bazë të normave që mbizotërojnë në datën raportuese. Zërat jo-monetarë që maten në bazën e kostos historike në një valutë të huaj nuk konvertohen. Diferencat në këmbimin valutës që paraqiten në zërat monetarë njihen si fitime ose humbje të periudhës në të cilën ato lindin.

h) Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

i) Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat nga interesi prej llogarive në banka dhe fitimet neto nga kursi i këmbimit që njihen në fitim ose humbje. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, komisionet bankare dhe humbjet neto nga kursi i këmbimit që njihen në fitim ose humbje.

j) Tatimi

Tatimi i tanishëm mbi të ardhurat kalkullohet në bazë të rregulloreve të aplikueshme në Kosovë ligjit nr. 06/L-105 mbi tatimin në fitim të korporatave i cili është publikuar më 27 qershor 2019.

Përfitimet e punonjësve

Kompania bën pagesa të kontributeve të obligueshme që ofrojnë përfitim të pensionit për punonjësit pasi të pensionohen.

k) Grantet qeveritare

Një grant qeveritar njihet vetëm atëherë kur ekziston një siguri e arsyeshme mbi kushtet prej të cilave përbëhet granti dhe që granti do të pranohet. Granti njihet si e ardhur gjatë periudhës që nevojitet të përputhet e ardhura me kostot e lidhura, për të cilat ata janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Nëse një grant bëhet i ripagueshëm, duhet të trajtohet si një ndryshim në vlerësimin. Kur granti është i lidhur me të ardhurat, shlyerja duhet të zbatohet fillimisht kundër ndonjë detyrimi të lidhur të paamortizuar të shtyrë, dhe çdo tejkalim duhet të trajtohet si shpenzime. Kur granti ndërlidhet me një pasuri, shlyerja duhet të trajtohet si rritje në vlerën kontabël të pasurisë ose zvogëlimin në bilancin e të ardhurave të shtyera. Amortizimi kumulativ që do të ishte ngarkuar nëse granti nuk do të ishte pranuar, duhet të ngarkohet si shpenzim.

Një grant i arkëtueshëm si kompensim për shpenzimet e bëra tashmë ose për mbështetje të menjëhershme financiare, pa shpenzimet e lidhura me të ardhmen, duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën ai është i arkëtueshëm. Përfitimi i një granti në një normë të ulët të interesit të tregut, trajtohet si një grant qeveritar, i matur nga diferenca midis të ardhurave të pranuar dhe vlerat e drejta të kredisë të bazuar në normat aktuale të interesit të tregut.

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

1) Detyrimet e mundshme dhe provizionet

Detyrimet e mundshme nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse gjasat e ndodhjes se tyre dhe përfitimet ekonomike nuk janë larg. Një aset i mundshëm nuk njihet në pasqyra financiare por shpaloset nëse pritet ndonjë fluks i përfitimeve ekonomike. Një provizion njihet nësesi rezultat i ngjarjeve të mëparshme kompania ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme është e mundur që benifitet ekonomike do të kërkohen për të shlyer detyrimin.

Më 31 dhjetor 2024 gjatë periudhës raportuese, kompania ka përfunduar me sukses një proces gjyqësor kundër **Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK)**, ku gjykata ka dhënë vendim përfundimtar në favor të kompanisë. Në bazë të këtij vendimi, kompania ka arkëtuar shumën prej **603,595 EUR** nga QKUK, e cila lidhet me detyrime të prapambetura për shërbime të ofruara. Në përputhje me **Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS)** dhe praktikat e kontabilitetit të pranuar, kjo shumë është trajtuar sipas SNK-ve, kurse në vitin 2025 ndërmarrja nuk ka pasur ndonjë proces i arketuar i ngjajshëm.

Vlerësimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Kompania bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Përcaktohet që, vlerësimet e kontabilitetit shumë rrallë do të jenë të barabartë me rezultatet e ndërlidhura aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të rëndësishëm për të shkaktuar një rregullim material të shumat bartëse të asetëve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë adresuar më poshtë.

Jetët e dobishme e pronës, impianteve dhe pajisjeve

Sic përshkruhet në shënimin a) më sipër, Kompania rishikon jetëgjatësinë e pronës, impianteve dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave apo faktor tjetër mund të ndikojë në jetët e dobishme të pasurive dhe në përputhje me rrethanat mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme vlerën kontabël neto të këtyre pasurive.

3. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Paraja në arkë	54	1,864
Llogaritë rrjedhese ne banka - Institucione	314,320	1,691,796
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	314,374	1,693,660

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

4. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Konsumatorët e sektorit të amvisërisë	15,843,976	15,517,646
Konsumatorët e sektorit afarist	3,322,514	3,059,609
Konsumatorët e sektorit institucional	1,292,340	1,292,340
Konsumatorët tjerë	918,838	865,711
(Lejimet ndaj konsumatorëve)	(15,972,790)	(16,123,756)
Gjithsej të arkëtueshmet tregtare	5,404,877	4,611,550

5. Stoqet

Stoqet më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Stoqet		
Mjetet Themelore në pritje	789,560	694,029
	211,979	205,003
Gjithsej stoqet	1,001,540	899,033

6. Pasuritë tjera afatshkurtëra

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Avanset për tatime në fitim		
Balanca kreditore e TVSH-së	72,012	84,170
Avanset (Kërkesat për Komunën e Prishtinës)	320,886	
Depozitat për KEK-un (Depoziti i kthyeshëm)	506,878	
Kërkesat tjera	167,396	28,164
Gjithsej pasuritë tjera afatshkurtëra	1,067,172	112,334

7. Prona, pajisjet dhe impiantet

Përshkrimi	Toka	Ndertesa	Automjete transportues dhe Inventar dhe pajisje	Investimet në vjim	Gjithsej
<i>Kostoja :</i>					
Me 01 Janar 2024	2,702,308	61,847,644	8,239,970	5,260,945	78,050,867
Shtesë	-	3,791,220	213,428	537,893	4,542,541
	-		378,322		378,322
Transferet e brendshme/korrigjimet		3,632,041		(3,447,591)	184,450
Me 31 Dhjetor 2024	2,702,308	69,270,905	8,831,720	2,351,247	83,156,180
Shtesë		11,848		2,729,333	2,741,180
Rivlerësim	10,673,080	6,537,555			17,210,636
Kthimet/korrigjimet		10,176,823			10,176,823
Me 31 Dhjetor 2025	13,375,388	85,997,131	8,831,720	5,080,580	113,284,820
Zhversimi i akumuluar:					-
Zhversimi i viti 2024	-	(20,648,838)	(7,631,289)		(28,280,127)
Zhversimi i viti 2025	-	(3,040,794)	(126,428)		(3,167,222)
Me 31 Dhjetor 2024	-	(23,689,632)	(7,757,717)		(31,447,349)
Zhversimi i vitit 2025	-	(3,760,481)	(332,627)		(4,093,107)
Me 31 Dhjetor 2025	-	(27,450,113)	(8,090,344)		(35,540,456)
Vlera neto kontabël 31 dhjetor 2024:	2,702,308	45,581,273	1,074,003	2,351,247	51,708,831
Vlera neto kontabël 31 dhjetor 2025:	13,375,388	58,547,019	741,377	5,080,580	77,744,363

8. Llogaritë e pagueshme tregtare

Përshkrimi	2025	2024
Furnitorët	€ 2,747,511	€ 1,705,125
Gjithsej llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	2,747,511	1,705,125

9. Kreditë dhe huatë afatshkurtra

Përshkrimi	2025	2024
Kredia, pjesa afatshkurtër	€ 654,000	€ 463,000
Gjithsej kreditë dhe huatë afatshkurtëra	654,000	463,000

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

10. Detyrimet tjera afatshkurtëra

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Detyrimet për kontributet pensionale	46,942	50,254
Detyrimet për tatimet në paga të punëtorëve	36,593	40,432
Detyrimet tjetër afatshkurtë (Ndermarrjen Banesore)	406,878	-
Detyrimet ndaj shpronësimit	911,136	911,136
Te Hyrat e shtyra detyrimet afatshkurta	42,596	3,028
Detyrimet tjera	28,043	109,717
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	1,472,189	1,114,566

11. Kreditë dhe huatë afatgjata

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Kredia, pjesa afatshgjatë		409,000
Gjithsej kreditë dhe huatë afatgjata	-	409,000

Kompania ka hyrë në marrveshje mes Qeveris Gjermane dhe KFW për marrjen e fondeve në vlerë 11,000,000.00euro prej të cilave:

- Kredia jo më shumë se: **5,000,000 €**
- Kontributi Financiar jo më shumë se: **6,000,000 €**

Kontrata kryesore për marrjen e fondeve është në mes të KFW, Frankfurt am Main dhe Republikës së Kosovës, pastaj Republika e Kosovës përmes kontratës së nën huazimit i ka bartë të drejtat dhe obligimet tek Kompania.

Huamarrësi (Kompania) do t'i përdorë Fondet ekskluzivisht për implementimin e Projektit të Kogjenerimit.

Huamarrësi do ti paguaj interesin Huadhënsit për shumën e kredis në normën prej 8.79%vj. Kredia në vlerë **5,000,000 €** nga KFW do të filloj të ripaguhet prej dhjetorit 2016, deri më dhjetor 2026.

Më 31 dhjetor 2025 bilanci i huamarrjes është **436,000 €** (31 dhjetor 2024: **409,000 €**)

Ndermarrja ne zhvillimin e projektit te solarve Kompania ka hyrë në marrveshje mes KFW për marrjen e kredive për zhvillimin e projektit duke filluar me gres periudhë duke filluar nga viti 2026 dhe nga vitit 2031, dhe kjo mvaret mvarsisht nga fillimii I implementimit të projektit.

Projekti HeatSave ndërmarrrja ka arritur ti siguroj dokumentacionin e nevojshëm për implmentin në pasqyra financiare i cili dokumentacion është i implementuar në kontabilitet sipas standardeve të raportimit financiar.

12. Provizionet afatgjata

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Provizionet afatgjata	-	77,590
Gjithsej provizionet afatgjata	-	77,590

13. Detyrimet tjera afatgjata

Grantet kanë të bëjnë me fondet ose pasuritë e fituara nga projekti i kogjenerimit si dhe projektete tjera me qëllim të veprimtarive operative të Kompanisë. Grantet e shtyra (Të hyrat e shtyra) përbëhen nga asete dhe të tjera të cilat i janë zhvilluar dhe janë duke u zhvilluara në përdorim Kompanisë për qëllim të Aktivitetit të saj.

Të hyrat e shtyra më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 përbëhen nga vlera neto janë trajtuar sipas SNK 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndhimën Qeveritare.

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Grantet në fillim të vitit		
Grantet e pranuar gjatë vitit /korigjimet	33,682,333	35,021,001
Amortizimi i granteve	11,432,288	1,211,148
	(2,874,462)	(2,549,816)
Gjithsej detyrimet tjera afatgjata	42,240,159	33,682,333

13. Detyrimet tjera afatgjata

Grantet në fillim të vitit

Grantet e pranuar gjatë vitit /korigjimet

Amortizimi i granteve

Gjithsej detyrimet tjera afatgjata

Ekuiteti dhe Kapitali Aksionar

Kapitali Aksionar

30

10

(2

40

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

Kompania është regjistruar në Agjensionin Kosovar për Regjistrimin e Bizneseve më 23 Dhjetor 2005. Sipas të dhënave nga dosja e regjistrimit, kapitali aksionar i Kompanisë ka shumën 25,000 euro, Kuvendi Komunal i Prishtinës ka në zotërim Kompaninë me 100%.

Kapitali Aksionar

	2025	2024
Kuvendi Komunal Prishtinë Kapitali i Pronarit	25,000	25,000
Total	25,000	25,000

Rezervat

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Rezerva e rivlersimit - Toka	10,673,080	-
Rezerva e rivlersimit - Objektet & Pajisje	5,992,944	€
Gjithsej	16,666,024	-

Me 31 dhjetor 2025, rezervat e rivlersimit janë 16,666,024 euro. Ndërmarrja kah fundi i vitit 2024 dhe në vazhdimin e vitit 2025 ka bërë rivlersimin e asetëve nga një kompani profesionale e angazhuar. Kapitali aksionar i regjistruar dhe plotësisht i paguar i Kompanisë, i përbërë nga aksione me vlerë nominale prej 1 EUR për aksion. Kuvendi Komunal e Prishtinës ka në zotërim Kompaninë. Aksionet janë të zakonshme dhe nuk ka kufizime apo preferenca të bashkangjitura.

14. Fitimi / (humbja) i/e mbajtur në fund të vitit

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Fitimi / (humbja) i / e mbajtur në fillim të vitit	21,548,793	18,142,390
Fitimi / (humbja) i / e vitit	1,336,283	2,471,029
Korigjimet e viteve paraprake	(1,157,634)	935,374
Gjithsej	21,727,442	21,548,793

15. Te hyrat

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Shijtet në sektorin e amvisërisë	6,388,221	7,256,557
Shijtet në sektorin afarist	1,380,527	1,335,753
Shijtet në sektorin institucional	2,952,927	2,886,327
Të hyrat nga rrjeti sekondar S.Banesor/Të hyrat nga rrjeti sekondar S.Afarist/Të hyrat nga kyqjet e reja/ Të hyrat nga shitja e mbeturinave	20,568	42,934
Të hyrat nga shitja e pa-autorizuarë e energjisë	93,605	17,051
Te hyrat e shtyra		763
Fitimi/Humbja nga shitja e mjeteve themelore		267,693
Të Hyrat nga provizionimet	1,517,804	1,608,486
Të hyrat tjera/ Të hyrat nga interesi/ Të hyrat nga taksat gjyqësore	87,772	(16,683)
Zbritjet gjatë faturimit/Zbritjet e lejuara nga faturimi	(576,733)	(1,068,677)
Gjithsej të hyrat	11,864,692	12,330,205

16. Kosto e mallit të shitur

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Kosto e energjisë elektrike - Distribuimi	139,878	256,514
Kosto e energjisë elektrike - Prodhimi/Kosto e energjisë elektrike - Prodhimi/Distribuim	922,368	81,351
Kosto e energjisë termike	1,742,323	1,663,503
Kosto e ujit për prodhim/mazutit/ Kosto e rregullimit të stokit	119,930	42,299
Kosto e rregullimit të stokut	86,495	
Kosto tjera (nafte, kimikalet, mazut)	10,006	483,525
Gjithsej Kosto	3,020,999	2,527,192

17. Te ardhurat tjera

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Amortizimi i granteve - Grantet nga Kuvendi Komunal Prishtinë	491,369	
Amortizimi i granteve - Projekti i kogjenerimit	2,383,093	2,549,816
Gjithsej te ardhurat tjera	2,874,462	2,549,816

18. Shpenzimet e shperndarjës

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Shpenzimet për rregullimin e rrugëve të dëmtuara	42,408	3,830
Shpenzimet e sigurimit të automjeteve	3,428	49,055
Shpenzimet e kontrollës teknike	411	2,024
Shpenzimet për taksa rrugore	2,048	3,681
Shpenzimet e taksave komunale	241	
Shpenzimet e ngritjes profesionale - trajnime	33,972	35,623
Shpenzimet materiale të mirëmbajtjes	41,428	913
Shpenzimet e materialit elektrik	7,729	
Shpenzimet për hixhienë	10,616	321
Shpenzimet për rroba mbrojtëse	1,940	7,332
Shpenzimet e sigurimeve te objektit	44,246	20,823
Gjithsej shpenzimet e shperndarjes	197,871	126,002
Shpenzimet e pagave	2025	2024
	€	€
Pagat dhe meditjet		
Sigurimet shëndetësore	3,460,382	3,339,617
Kontributet pensionale	82,130	
Gjithsej shpenzimet e pagave	177,124	170,149
	3,719,636	3,509,765
Gjithsej shpenzimet e shperndarjes	3,917,507	3,635,767

19. Shpenzimet administrative

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Shpenzimet e provizioneve bankare		10,500
Shpenzimet e mbeturinave		5,956
Shpenzimet për bazhdarimin e valvolave	1,816	12,621
Shpenzimet për festa	3,918	7,685
Shpenzimet për sigurimet shëndetësore	11,297	5,726
Shpenzimet financiare (kamatë vonesa)		309
Shpenzimet për bazhdarimin e matsve te energjis ne nestacionin HES-HRS		
Shpezimet e zotimit te kredisë	21,000	9,916
Shpezimet e zotimit te kredisë		1,778
Shpenzimet për mirëmbajtjen e pompave		42,395
Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuteri	84	78,319
Shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve	1,428	45,893
Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve	11,567	36,972
Shpenzimet për mirëmbajtjen e oborrit	16,914	10,470
Shpenzimet për mirëmbajtjen e programeve soft.	39,175	258
Shpenzimet e telefonisë fikse	10,169	3,319
Shpenzimet e telefonisë mobile	261	3,788
Shpenzimet për mbushje telefonike	2,956	5,446
Shpenzimet per fizibilitet te mbulushmerise per Prishtinen	7,521	328
Shpenzimet për tatimin në pronë	193,669	5,029
Shpenzimet e internetit	3,745	41,999
Shpenzimet per rivlersimin e asetëve	5,814	1,415
Shpenzimet e Qirasë	41,441	14,850
Shpenzime për bursa të studentëve	14,818	11,982
Shpenzimet për mirëmbajtjen e web faqes	10,500	1,290
Shpenzimet për taksa gjyqësore	945	585
Shpenzimet për kamata gjyqësore	440	6,995
Shpenzimet për shpallje dhe njoftim	46,921	1,337
Shpenzimet e reprezentacionit	750	1,780
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar	9,420	980
Shpenzimet për ekskurzion	34,862	7,529
Shpenzimet e promovimit të afarizmit	34,350	5,388
Shpenzimet e byfesë	90,692	60,080
Shpenzimet për larje të automjeteve	5,237	10,254
Shpenzimet për mbrojtje kundër zjarrit	1,194	911
Shpenzimet e derivateve	940	6,251
Shpenzimet për avokat	10,428	990
Shpenzimet e përmbarimit	1,310	566
Shpenzimet e përmbarimit - Tarifa për Efikasitet	117,939	630
Shpenzimet për liçencë për shpërndarje të ngrohjes	9,813	63,414
Shpenzimet tjera	35,216	434
		50,019
Gjithsej shpenzimet administrative	798,550	576,387

20. Shpenzimet e zhvlerësimit

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Shpenzimet e zhvlerësimit - kategoria 5%	3,760,481	3,298,152
Shpenzimet e zhvlerësimit - kategoria 10%	287,181	
Shpenzimet e zhvlerësimit - kategoria 20%	45,445	
Gjithsej shpenzimet e zhvlerësimit	4,093,107	3,298,152

21. Shpenzimet e tjera

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Shpenzimet nga provizionet e Llogarive të Arkëtueshme	1,118,255	1,951,012
Shpenzimet e tjera	7,670	8,787
Gjithsej shpenzimet tjera	1,125,925	1,959,799

22. Shpenzimet financiare

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Shpenzimet e interesit të kredisë	46,485	111,696
Shpenzimet e provizioneve bankare	35,685	
Shpenzimet financiare (kamatë vonesa)	38,549	
Shpenzimet e zotimit të kredisë	117,073	
Gjithsej shpenzimet financiare	237,793	111,696

23. Shpenzimet e tatimit në fitim

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

Sipas ligjit nr. 06/L-105 "Mbi tatimin në të ardhurat e korporatave", në fuqi nga 27 qershori 2019, norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave ka qenë 10%.

Përshkrimi	2025	2024
	€	€
Tatimi aktual i vitit	152,988	260,000
Subvencionet e dhena per sponsorizim	(56,000)	(40,000)
Tatimi i shtyrë	-	-
Gjithsej	208,988	300,000
Korigjimi të shpenzimeve për qëllime të tatimit në fitim		
		2025
		€
Fitimi para tatimit		1,545,271
Shpenzimet e zhvleresimit nga rivleresimi		544,611
Fitimi para tatimit për qëllime tatimore		2,089,883
Tatimi në fitim *10%		208,988

24. Transaksionet me palët e lidhura

Një person ose një palë e afërt e familjes së atij personi është e lidhur me Kompaninë raportuese nëse ai person:

- i. ka kontroll ose kontroll të përbashkët mbi Kompaninë raportuese;
- ii. ka ndikim të rëndësishme mbi Kompaninë raportuese; ose
- iii. është anëtar i menaxhmentit kyq të Kompaninë raportuese ose mëmë të Kompanisë raportuese.

Një entitet është i lidhur me Kompaninë raportuese nëse ndonjë prej kushteve të mëposhtme aplikohet:

- i. Entiteti dhe Kompania raportuese janë anëtare të të njëjtit grup (që do të thotë që çdo entitet mëmë, filialë dhe degë filiale është e lidhur me të tjerët).
 - ii. Entiteti është shoqëri ose ndërmarrje e përbashkët e entitetit tjetër (ose një shoqëri apo ndërmarrje e përbashkët e një anëtari të grupit në të cilën shoqëria tjetër është anëtar).
 - iii. Të dyja entitetet janë ndërmarrje të përbashkëta të së njëjtës palë të tretë.
 - iv. Njëri entitet është ndërmarrje e përbashkët e e palës së tretë dhe entiteti tjetër është shoqëri e entitetit të tretë.
 - v. Entiteti është një plan përfitimi pas punësimit për përfitimet e punëtorëve të entitetit raportues ose një entiteti të lidhur me entitetin raportues. Nëse entiteti raportues është një plan I tillë, punëtorët sponsorues janë gjithashtu të lidhur me entitetin raportues.
 - vi. Entiteti është i kontrolluar ose ka kontroll të përbashkët nga një person i afërt ose një anëtar i afërt i familjes së atij personi.
 - vii. Një person i lidhur ka ndikim të rëndësishëm mbi entitetin ose është anëtar i menaxhmentit kyq të entitetit (ose Kompanisë mëmë të entitetit).
- Një transaksion me një palë të lidhur është një transfer i resurseve, shërbimeve ose obligimeve mes Kompanisë raportuese dhe një pale të lidhur, pavarësisht nëse çmimi është ngarkuar.

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

Gjatë vitit Kompania kishte transaksione me palët e ndërlidhura si në vijim:

Me 31 dhjetor:	2025	2024
Pagat për Bordin dhe komisioni Komunal I Aksionarve	86,121	82,909
Paga vjetore e Kryeshefit Ekzekutiv	39,649	38,160
	125,769	121,069

25. Menaxhimi i rrezikut financiar

Kompania është ekspozuar ndaj rreziqeve të meposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredise
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Kompanisë ndaj secilit prej rreziqeve të mesipër, objektivat, politikat dhe proceset e Kompanisë për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit, shënime të metejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare. Administratori i Kompanisë mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikeqyrjen e politikave të Kompanisë për menaxhimin e rrezikut.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Kompanisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Kompania, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Kompanisë. Kompania, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentet financiare kryesore të Kompanisë konsistojnë në vlerat në arke dhe në banka, huamarrjet, llogaritë e arketueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera afatshkurtra

(i) Rreziku i kredisë

Rreziku i mos-pagueses ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet për pagesën e llogarive të arketueshme.

Maksimumi i rrezikut të kredise për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arketueshme minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Rreziku i kredise i cili është identifikuar merret parasysh nepermjet zhvleresimeve, Kompania e vlereson çilesinë e llogarive të arketueshme që nuk janë me vonese dhe as të zhvleresuara si shumë të kenaqshme.

Me 31 dhjetor	2025	2024
Paraja dhe ekuivalentët e parësë	314,381	1,693,659
Llogaritë e arketueshme tregtare	5,404,877	4,611,650
	5,719,258	6,305,309

(ii) Rreziku i likuiditetit

Kompania duhet të përmbushë nevojat për mjete monetare, kryesisht për kostot e shfrytëzimit që rrjedhin nga aktivitetet e saj. Ekziston rreziku që mjetet monetare mund të

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

mos jene te disponueshme per te shlyer detyrimet ne kohen e duhur me nje kosto te arsyeshme. Kompania monitoron likuiditetin ne baza periodike ne menyre qe te menaxhoje detyrimet e saj kur ate kerkohen.

Përshkrimi	2025	2024
PASURITË:	€	€
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	314,374	1,693,660
Stoqet	1,001,540	899,033
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	5,404,877	4,611,550
Pasurit tjera	1,067,172	112,334
Gjithsej Pasuria	7,787,962	7,316,576
DETYRIMET:		
Detyrimet tregtare dhe të tjera	2,747,511	1,705,125
Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve tjera	654,000	463,000
Detyrimet tjera afatshkurta	1,472,189	1,114,566
Gjithsej Detyrime	4,873,700	3,282,691
Hapsira e likuiditetit	2,914,262	4,033,885

(iii). Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Kompania menaxhon kapitalin e saj duke siguruar aftësi të vazhdojë aktivitetet sipas hipotezë së vijimësisë për deri sa maksimizojnë kthimet për pronarin përmes optimizimit të balancë së borxhit dhe ekuitetit.

Struktura e kapitalit të kompanisë përbëhet nga borxhet, të cilat përfshijnë huatë dhe ekuiteti i atribuushëm te mbajtësit e ekuitetit, që përbëhet nga kapitali dhe fitimet e mbajtura.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Menaxhmenti i kompanisë konsideron se vlera bartëse e pasurive dhe detyrimeve financiare të regjistruara me kosto ose kosto të amortizuar në pasqyrat financiare është e përafërt me vlerën e drejtë të tyre për shkak të maturitetit të shkurtër të tyre.

26. Kontigjencat dhe zotimet

Detyrimet ndaj tatimeve

N.P. "TERMOKOS" SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2025

Të gjitha shumat në Euro

Pasqyrat financiare dhe regjistrimet kontabël të kompanisë nuk janë audituar nga autoritetet e taksave për periudhën 01 janar 2025 – 31 dhjetor 2025 kështu që obligimet tatimore të Kompanisë nuk mund të konsiderohen si të përfunduara.

Çështjet gjyqësore

Konteste gjyqësore gjate viteve deri më 2025 vazhdojnë të jenë përfaqësues të njëjtat si ato të vitit 2024, 26 raste N.P "Termokos" vazhdon të jete në konteste procedurale si palë paditse dhe e paditur pran gjykatave, dhe deri me tani me 2025 nuk mund te percaktohen implikimet financiare te cilta mundë të ndodhin ne favore apo disfavore për kompanin. Kompania ka dërguar klient ne process permbarimore gjatë vitit 2025, kompanija sipas rasteve gjyqësore si paditse dhe e paditur ne vitet në vijim pritet që rastet ti humb në vlerë prej 600,935.73 ndersa rastet të cilat pretendon ti fitoj 16,296.63.

27. Ngjarjet pas datës së raportimit

Pas datës 31 dhjetor 2025 dhe deri në nxjerrjen e këtyre pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje tjera që do të ketë nevojë për shpalosje në pasqyrat financiare.